

Gazeta “POLITIKA” është një tjetër gazetë jetëshkurtër në vend, pati jetë për gati dy vjet, 2007-2008. Erdhi në mjedisin shqiptar me ambicje të mëdha kur në fakt situatat politike dhe zhvillimore në vend kishin nevojë për një frymë të re. Krizën e provokoi klima e korrupsionit të thelluar që la pushteti i PS-së dhe pushteti pa perspektivë i Berishës së dytë.

Unë u angazhova në këtë klimë. Madje, shkrimet e mia kishin një mbrehtesi dhe një përkushtim në favor të nevojës së ndryshimit të klimës demokratike në vend. Por ishte e pamundur. I detë e kishin humbur betejën para parasë.

Në katër muajt e parë të jetës së gazetës, Janar-prill 2007, botova 9 artikuj me 23 faqe. Shkrime të tilla si “Marshet e ndryshkura nuk duhet të “ndryshkin” marrëdhëniet Shqipëri Greqi”, apo “Bollano i Prillit në dy stinë”, tregonin qartë se kriza shqiptare po kërkonte rrugëdalje tek kriza e marrëdhënieve me Greqinë dhe për këtë përdorshin edhe provokimet e lidërshit të OMONIAS.

Po ashtu për herë të parë u artikulua në medjan shqiptare ideja se politika ushqen krimin nëpërmjet shtetit.

Εισαγωγή

Η εφημερίδα “POLITIKA” είναι μια ακόμα εφημερίδα σύντομου βίου. Κυκλοφόρησε για περίπου δύο έτη, 2007-2008. Ήρθε στην αλβανική επικαιρότητα με μεγάλες προσδοκίες, όταν στην πράξη οι πολιτικές καταστάσεις και εξελίξεις στη χώρα είχαν ανάγκη για ένα νέο πνεύμα. Την νέα κρίση προκαλούσαν το κλίμα βαθύτατης διαφθοράς που άφησε πίσω η κυβέρνηση των σοσιαλιστών και η κυβέρνηση χωρίς προοπτική του δεύτερου Σαλί Μπερίσια.

Εγώ δεσμεύτηκα στο κλίμα αυτό. Μάλιστα, τα άρθρα μου διακρίνονταν για την οξύτητα και αφοσίωση υπέρ της ανάγκης βελτίωσης του δημοκρατικού κλίματος στη χώρα. Αλλά ήταν αδύνατο. Οι ιδέες είχαν χάσει τα πάντα στην μάχη με το χρήμα.

Σε τέσσερις πρώτους μήνες της εφημερίδας Γενάρη-Απρίλη 2007, δημοσίευσα 9 άρθρα. Θα έλεγα με τη μεγαλύτερη πυκνότητα από κάθε άλλη εφημερίδα. Τέτοια επίσης άρθρα, όπως «Τα σκουριασμένα εμβλήματα δεν επιτρέπεται «να σκουριάσουν» τις Σχέσεις Ελλάδας-Αλβανίας, ή «Ο Μπολάνος του Απρίλη σε δύο εποχές» (υπάρχει και μεταφρασμένο) έδειχναν ξεκάθαρα ότι η αλβανική κρίση ζητούσε διέξοδο στην ελληνοαλβανική κρίση και γι' αυτό αξιοποιούνταν και οι προβοκάτσιες της ηγεσίας της OMONOIAS. Επίσης για πρώτη φορά στην αλβανική επικαιρότητα έλαβε θέση η ιδέα ότι η πολιτική τροφοδοτεί το έγκλημα μέσω του κράτους.

PERMBAJTJA

1. **Maxhoranca pa të drejta**
29.01.2007 faq. 3.
2. **Kulçedra-politikë dhe jeta jonë e rrezikuar**
02.02.2007 faq. 6.
3. **Zgjedhjet lokale jasht kontekstit administrativ.**
04.02.2007 faq. 8.
4. **Berisha në rrethim të dyfishtë**
03.03.2007/03.03.2007 faq. 12.
5. **Marshe të ndryshkura nuk duhet të “ndryshkin” marrëdhëniet Shqipëri
Greqi.**
09.03.2007 faq. 14.
6. **Topi –president, çimentim i pushtetit të Berishës.**
22.03.2007 faq. 16.
7. **Politika ushqen krimin nëpërmjet shtetit.**
06.04.2007 faq. 18.
8. **Bollano i Prillit në dy stinë**
28.04.2007 faq. 21.
9. **Përkthimi –Μετάφραση** faq. 24.
10. **Fund.** faq. 27

Nga Panajot Barka Maxhoranca pa të drejta 29.01.2007

E hënë 29 janar 2007

MAXHORANCA PA TË DREJTA



PANAJOT BARKA

Korruptimi i politikës në emër të interesave personale i ka deformuar asaj, deri në të kundërt, funksionin e vet shoqëror e demokratik dhe i ka shmangur totalisht vemendjen nga detyrimi për të mbrojtur të drejtat e njëriut në përgjithësi dhe të minoriteteve në veçanti. Madje, nuk mund të thuhet tepër nëse akuzojmë politikën si përgjegjëse kryesore të cenimit të së drejtës së njeriut për të jetuar, ose të derivimit të të drejtave të tij në përpjekjet e gjithanshme për mbijetese vegetuese. Kështu mund të përkthehet fakti që e drejta jetike për të pasur ujë e drita 24 orë në ditë është kthyer në një të drejtë pasive për të shpresuar te shtimi sadopak i minutave me ujë në ditë dhe te shkurtimi i kohëzgjatjës së ndërprerjeve të energjisë elektrike. Që e drejta para ligjit dhe e drejta për t'u arsimuar ekuivalentohen me qesën me para. Kështu mund të konkludohet kur zhgënjimi dhe pamundësia për të vazhduar jetën, vret çdo ditë nga një shqiptar, kur krimi është ulur këmbëkryq në familje dhe një e treta e shqiptareve ka marrë rrugët e mërgimit në kërkim të mundësisë për të jetuar si njeri.

Pra, individët përbërës të politikës dhe pikë së pari ata që zotërojnë pushtetin politik, përbëjnë sot monopolin vrastar të së drejtës së njëriut, aq sa është i pamjaftueshëm dhe i pavlefshëm kthimi (prej njëriut të thjeshtë) kraheve politikës.

i njohur në vend dhe me disa të drejta - vitrinë socialiste të saksionuara në letër. Por se me këtë minoritet është identifikuar forca politike që ka marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, - PBDNJ-ja. Grupi politik i kësaj partie përdori fuqinë magjike që kanë të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve për nivelin e demokracisë së një vendi në arenën ndërkombëtare, për t'u bërë presion partive në pushtet që t'i hapnin pak vend në ndarjen e tortës së pushtetit. Këto parti shumë shpejt e kuptuan se do t'i lanin duart me të drejtat e minoriteteve po të merrnin në mbrojtje dhe t'i krijonin privilegje grupit politik të kësaj partie. Dhe kështu ndodhi. Kujtojmë lexuesit se kjo parti është në pushtet që kur u themelua, më 1992 dhe pjesa e tortës së pushtetit erdhi duke u rritur. Në përpjestim të zhdrejtë u vendos rritja e përfitimeve personale nga pjesëmarrja në pushtetin politik të grupit politik të PBDNJ, me përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Dhe sa më shumë ky grup politik e braktiste misionin për të cilën u krijua, (përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve), aq më shumë ajo bëhej e domosdoshme për forcat politike që pretendojnë pushtetin. Kujtojmë lexuesit se në të gjitha lojrat politike me "Dushqet", (të medhenj e të vegjel) kjo parti ishte protagoniste.

Me të drejtë zgjedhësit e minoritetit etnik grek thonë se ne me votat tona e nxjerrim nga dera e Parlamentit PBDNJ-në, partitë politike në pushtet e fusin atë nga dritarja. Kjo ndodh se minoriteti etnik grek e ka kuptuar se PBDNJ, as mund të mbrojtë as mund të përfaqësojë të drejtat e tij. Vetëm mund të abuzojë me to në emër të përfitimeve personale. Ashtu si forcat politike në pushtet e kanë kuptuar se duke patur në parlament dhe në qeveri PBDNJ-në, u hedhin hi syve instrumentave ndërkombëtare për nivelin e respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Kujtojmë si Berisha, gjatë vizitës në Athinë më 12 shtator 2006, me një përgjigje të ngjashme ua mbylli gojën gazetarëve grek, kur ata e pyetën për respektimin e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri?!!!!

politikës mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në këtë kuadër rendësa e fajit bie mbi minoritetin grek, i cili është njëkohësisht viktima e parë dhe më tragjike e kësaj loje. Dhe jo për faktin se minoriteti grek është minoriteti etnik më i madhë, më i njohur në vend dhe me disa të drejta - vitrinë socialiste të saksionuara në letër. Por se me këtë minoritet është identifikuar forca politike që ka marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave të njëriut në Shqipëri, - PBDNJ-ja. Grupi politik i kësaj partie përdori fuqinë magjike që kanë të drejtat e njëriut dhe të minoriteteve për nivelin e demokracisë së një vendi në arenën ndërkombëtare, për t'u bërë presion partive në pushtet që t'i hapnin pak vend në ndarjen e tortës së pushtetit. Këto parti shumë shpejt e kuptuan se do t'i lanin duart me të drejtat e minoriteteve po të merrnin në mbrojtje dhe t'i krijonin privilegje grupit politik të kësaj partie. Dhe kështu ndodhi. Kujtojmë lexuesit se kjo parti është në

Korruptimi i politikës në emër të interesave personale i ka deformuar asaj, deri në të kundërt, funksionin e vet shoqëror e demokratik dhe i ka shmangur totalisht vemendjen nga detyrimi për të mbrojtur të drejtat e njëriut në përgjithësi dhe të minoriteteve në veçanti. Madje, nuk mund të thuhet tepër nëse akuzojmë politikën si përgjegjëse kryesore të cenimit të së drejtës së njëriut për të jetuar, ose të derivimit të të drejtave të tij në përpjekjet e gjithanshme për mbijetese vegetuese. Kështu mund të përkthehet fakti që e drejta jetike për të pasur ujë e drita 24 orë në ditë është kthyer në një të drejtë pasive për të shpresuar te shtimi sadopak i minutave me ujë në ditë dhe te shkurtimi i kohëzgjatjës së ndërprerjeve të energjisë elektrike. Që e drejta para ligjit dhe e drejta për t'u arsimuar ekuivalentohen me qesën me para. Kështu mund të konkludohet kur zhgënjimi dhe pamundësia për të vazhduar jetën vret çdo ditë nga një shqiptar, kur krimi është ulur këmbëkryq në familje dhe një e treta e shqiptareve ka marrë rrugët e mërgimit në kërkim të mundësisë për të jetuar si njeri.

Pra, individët përbërës të politikës dhe pikë së pari ata që zotërojnë pushtetin politik, përbëjnë sot monopolin vrastar të së drejtës së njëriut, aq sa është i pamjaftueshëm dhe i pavlefshëm kthimi (prej njëriut të thjeshtë) kraheve politikës. Madje, duket se kjo i intereson me shumë asaj, se i ka duart më të shpenguara në lirinë e vet.

Fat me i hidhur iu rezervua të drejtave të minoriteteteve që kur këto minoritete i lëjuan

pushtet që kur u themelua, më 1992 dhe pjesa e tortës së pushtetit për të erdhi duke u rritur. Në përpjestim të zhdrejtë u vendos rritja e përfitimeve personale nga pjesëmarrja në pushtetin politik të grupi politik të PBDNJ-shit, me përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Dhe sa më shumë ky grup politik e braktiste misionin për të cilën u krijua, (përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve), aq më shumë ajo bëhej e domosdoshme për forcat politike që pretendojnë pushtetin. Kujtojmë lexuesit se në të gjitha lojrat politike me “Dushqet”, (të medhenj e të vegjel) kjo parti ishte protagoniste. Me të drejtë zgjedhësit e minoritetit etnik grek thonë se ne me votat tona e nxjerrim nga dera e Parlamentit PBDNJ-në, partitë politike në pushtet e fusin atë nga dritarja Kjo ndodh se minoriteti etnik grek e ka kuptuar se PBDNJ-shi as mund të mbrojë as mund ta përfaqësojë të drejtat e tij. Vetëm mund të abuzojë me to në emer të përfitimeve personale. Ashtu si forcat politike në pushtet e kanë kuptuar se duke patur në parlament dhe në qeveri PBDNJ-në u hedhin hi syve instrumentave ndërkombëtare për nivelin e respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Kujtojmë si Berisha, gjatë vizitës në Athinë me 12 shtator 2006, me një përgjigje të ngjashme ua mbylli gojën gazetarëve grek, kur ata e pyetën për respektimin e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri?!!!)

Tregojmë për këtë një shembull të vogël. Çeshtja e shkollimit në gjuhën amtare të anëtarëve të këtij minoriteti përbën një detyrim kushtetues të çdo force politike në pushtet në vend. Në vitet e fundit, kur PBDNJ ishte në pushtet, 8 vjet me PS-në dhe tani 2 vjet me PD-në, nga shkollat publike në gjuhën amtare të arsimit të detyrueshëm në minoritetin etnik grek filluan të firasin tekstet për lëndet në gjuhën greke, aq sa këtë vit nxënësit e këtyre shkollave i marrin me shenime të gjitha mësimet në lëndet në gjuhën amtare. Një situatë, që për shkollat e këtij minoriteti ishte e panjohur dhe në fillimet e shekullit të kaluar. Ose, kjo parti me mbeshtetjen e qeverisë së partisë në pushtet, ka ndërmarrë këto dy vitet e fundit një fushatë përndjekjesh të kundërshtarëve politikë ose personal brenda në minoritet, (qoftë ata në marrëdhënie pune me shtetin qoftë ata me punë private) ndërkohë që paguan me rroga të majme nga Ministria e Punës që i përket PBDNJ-së, militantë–shërbëtorë të saj. Nga këto pozita, në asnjë moment në serinë e pafundme të shkeljës së të drejtave të njëriut, deri në atë themelore për demokracinë siç është vota e lirë, kjo parti nuk ka ngritur zërin për të denuar këto shkelje. (Si mund ta bej kur është vet protagoniste dhe nga këto shkelje kërkon të përfitoj e para dhe sa më shumë politikisht) Në këtë kuadër gjithësecili nxjerr konkluzionet e veta për fatin e të drejtave të minoriteteve të tjerë të “përfaqësuar” nga kjo parti.

Po ashtu nuk mund të mos vihet re se PD-ja në pushtet, ndryshe nga PS-ja, po përdor tani PBDNJ-në si instrument politik për të realizuar politikën e njohur diskriminuese ndaj këtij minoriteti.

Për minoritetin etnik grek, është fatkeqësi edhe fakti që PBDNJ-shi si një parti e cila duhej të reflektonte parime politike të bazuara në standarte Evropiane, pragmatizmi vulgar e ka shndërruar në një lavjerës të të dy sahatëve politikë kryesorë në vend. Dihet historikisht që komuniteti i minoritetit të sotëm etnik grek kurrë nuk ka pranuar një rol të tillë (të shkonte me më të fuqishmin apo me fitimtarin), qoftë edhe kur iu vu në rrezik identiteti i vet etnik. Përndryshe nuk do të gëzonte respektin e shumicës. Pra, grupi politik i PBDNJ-së duket se s’ka asnjë lidhje as me traditën e komunitetit që pretendon se përfaqëson e as me parimet politike të parashikuara në aktet, konventat e institucionet ndërkombëtare.

Nga ana tjetër grupi politik i kësaj partie duket se abuzon shumë me pozicionin dhe rolin që ka Greqia fqinje në strukturat euroatlantike. Abuzimi qëndron në faktin se ky rol reflektohet në interesin e forcave politike në vend për përfitim të përkrahjes së Greqisë në këto struktura. Këtë rol përfaqësues të Greqisë në Shqipëri përpiqet ta marrë

përsipër PBDNj-shi. Dhe partitë politike Shqiptare në një masë të konsiderueshme e kanë besuar këtë pretendim. Ose, kanë shlyer detyrimet ndaj të drejtave të minoritetit etnik grek duke futur në parlament dhe qeveri përfaqësuesit e kësaj partie. (Ajo që quhet përvoja e sistemit komunist). Në këtë këndvështrim, dalin të humbur si minoriteti grek, ashtu edhe Shqipëria e Greqia por me shumë marrëdhëniet midis vendeve, me fitues të vetëm grupin politik të PBDNj-së.

Si konkluzion final mund të themi se fatkeqësia me e madhe për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve qëndron te fakti se mbrojtja e tyre është politizuar ose është venë në shërbim të interesave të grupeve politike dhe përbën nivelin më të lartë të abuzimit dhe korrupsionit si dhe stërkembëshin më të pakëpërxyeshëm për proceset demokratike në vend.

P. Barka Për F, Çupin. POLITIKA

Nga Panajot Barka

Kulçedra-politikë dhe jeta jonë e rrezikuar

02.02.2007

Një vajzë e re nga fshati e punësuar në qytet, kishte dy ditë që tregonte më e gëzuar se herët e tjera. Kur e pyetën për arsyen ajo e lidhi gëzimin e saj me faktin se për dy ditë e dy net me rradhë në fshatin e saj nuk ishte ndërprerë energjia elektrike. Ajo nuk e dinte, por, ngjarja “e rrallë” ndodhte për faktin se në fshatin e saj kishin vdekur njëri pas tjetrit dy të moshuar. Thonë nga të ftohtit dhe veshtirësitë që shkakton mungesa e dritave. M’u kujtua mënjëherë një legjendë që qarkullon në anët tona me kulçedrën e cila për t’u lëshuar ujin banorëve donte për vete ditë për ditë, ose javë për javë nga një vashë të re.

Midis mitit në legjendë dhe mitit të realitetit tonë përveç ngjashmërisë së plotë ka dhe disa dallime që e bëjnë me të rendë situatën.

Së pari. Kulçedra na paraqitet një e keqe e madhe që torturonte banoret e krahinës me gjenë më jetësore siç është uji. Por ajo është diçka konkrete, një egërsirë e frikshme që pranohen nga parametrat e çdo fantazie tmërri, e vendosur në guvën e burimit jetëdhënës. Po në rastin tonë. Ç’fytirë ka “kulçedra” jonë e dritave. Kuptohet nuk ka si të legjenda një personifikim konkret të së keqës, por abstrak. Është politika. Konkretën duhet ta kërkojmë të shpërndarë, të njëjzës dhe politikës, të kostumeteve e të makinat e tyre luksoze, të hotelet e tyre private dhe të të gjitha pasuritë e tyre përralloore të vena pa asnjë bulezë djerse nga balli i lëmuar nga dhjami.

Së dyti. Kulçedra te legjenda e moçme nuk dihet nga ka ardhë. Është diçka e huaj për komunitetin që i rrembente ujin, por edhe e huaj për natyrën njëjzësore. Mund të jetë edhe produkt i fandazisë së njëriut, por që e trajton atë si më lartë përshkruam “Kulçedra”jonë është produkti i vet njëriut. Shikoni pra politikanët tanë, ose elementët përbërës të kulçedrës. Paguajnë shumë shtrenjtë qoftë edhe për një vend të ulët në hierarkinë politike. Vriten e priten për ta zenë atë duke u përbetuar se këtë “sakrificë”, me paratë “përsonele” të harxhuara për të bindur popullin që ta përkrah (ta votojë) me premtimin se ai do të jetë një sherbetor i tij. (Të nësërmën provon se kjo është një mënyrë për të dhjetëfishuar apo qindfishuar pasuritë e tij përsonele. “Në emer të sherbesave ndaj popullit”).

Në të dyja rastet “kulçedrat” kanë arritur t’i imponojnë komunitetit vullnetin dhe realitetin e tyre zhatës e poshtërues.

Së treti dallimi tjetër qëndron te fakti se ndërsa në rastin e parë, te legjenda, komuniteti gjeti një zgjidhje apo disa variante, për të shpëtuar nga kulçedra dhe poshtërimi i saj dhe ia arriti. Madje gjithë rrefimi për atje nxiton, për tek zgjidhja e shumë pritur e shpëtimit nga kulçedra. Në rastin tonë zgjidhje nuk ka. Përkundrazi. (Besoj te gjithë e dinë fundin e kulçedrës te legjenda. Por jo pa qëllim po e rikujtoj shkurtimisht:- Një plak i mençur i propozoi komunitetit që po vuante nga tekat e kulçedrës, ta linin atë pa ushqimin e saj të preferuar,- trupin e një vashë gjërsa të lodhej nga uria..Pasi ndodhi kjo, një ditë iu avit strofkës së kulçedrës me një kafshë ngarkuar me lëndë lisi. Brenda në ngarkesë kishte fshehur eshkë të ndezur. Kulçedra e urritur sa ndjeu erën e mishit u sul dhe kollofiti kafshën me ngarkesë dhe plakun bashkë. Plaku ishte i përgatitur për këtë sakrificë. Mirëpo pasi kaluan disa orë eshka u ndez dhe u kthye në flakë që përpiu nga brenda barkun e dhjamur të kulçedrës. Ajo doli nga strofulla dhe mori malit tej për tej. Rrugës villte çfarë kishte kapërdirë për të shpëtuar por nuk shpëtoi dot. Në atë faqe mali, në të dy anët nga kaloi kulçedra tani janë dy rradhë me lisa !!).

Tek ne ç’ po ndodh. Hiç, po kthehemi që të terrë në ushqim për politikën. Përpiqemi ose për të zenë rradhë për t’u bërë pjesë e politikës, ose ta kemi mirë me të për të

zgjdhur secili hallet e veta. Kështu që politikanet tanë nuk kanë se si t'i kujtojnë rreshtat me pemë lisi në atë pllajë mali.... Ata kanë harruar t'u besojnë legjendave. Dhe e dini përse? Se tek ne ndodh edhe si te fabula tjetër që tregojnë për delen edhe ujkun. Konkretisht thonë se kur një ujk plagos një dele dhe ujku i trembur nga çobenjtë largohet delja e plagosur i vete nga prapa.

Për gati dy dekada po ne të gjithë po tregojmë me gisht politikanët tanë. I akuzojmë ata (sikur të jenë bisha), si shkaktarë kryesor sepse nuk u ndërtua apo se u shkatërrua shteti, se na vranë apo na plagosen endrrën dhe shpresën, se mirëqënja dhe perspektiva jonë po vihet në pikëpyetje. Por sa fanepsën ata, turavrap u sulën nga prapa turmat (e deleve të plagosura) për t'i ndjekur e glorifikuar. Nuk vemë re as cinizmin, as hipokrizinë e tyre ndaj nesh. Shohim se si votën tonë ata e kanë kthyer në një thikë me dorezë të fildisht. Thikën na e kanë ngulur neve dhe ne shikojmë dorezën e fildisht në duart e tyre tek e rrotullojnë për t'u siguruar për qëllimin e tyre. Nuk e kuptojmë se ç'po ndodh. Veçse përplasim duart sipas një havazi të vjetër.

Marrim një shembull. Berisha dhe Nano. Berisha, sipas Nanos, i vuri flakën Shqipërisë. Ai duke e përdorur këtë fakt si gogol arriti të qeveris vendin për tetë vjet. Nanua, sipas Berishës, është padrinoja, simboli i kleptokracisë dhe i korrupsionit, akuza të cilat e sollën atë në pushtet. (Të dy kanë të drejtë, pavarësisht se askush nuk mori përsipër për të vertetuar akuzat e ndërsjellta, as ato akoma për organizimin e një grushti shteti) Të dy këta pra, kur nuk rrezikohen në pushtetin e tyre janë armiq të përbetuar të njëri – tjetrit dhe kur u rrezikohet pushteti kërkojnë ndihmën e njëri-tjetrit. I pamë para do kohësh te takohen sërish midis tyre në mes të ditës. (Pas daljes me dëshirë në pension politik të Nanos po i vinte radha Berishës për ta ndjekur pa dëshirë) Në duart e shtrenguara midis tyre lexohej hapur plani për të mbajtur njëri tjetrin në krye të politikës-në krye të shtetit,- në krye tonë. Madje morën përsipër të tregojnë ata se kush janë “të paudhët” e vertetë të politikës shqiptare!!!. Reagimi për këtë cinizëm të paskruptull i padukshëm krahasimisht me turmën e atyre që i ndoqën nga pas, nga ata që në betejat politike për të përkrahur Nanon ose Berishën humbën dinjitetin njërezor dhe ato pak vlera intelektuale, në këmbim të një cope buke, ose edhe të një pasurie përalllore.

Kjo situatë na kujton akoma një fabul tjetër. Atë më shprehëse të turmës e aspak të komunitetit. Turma, si tufa e bagëtisë që në një moment pasigurie, një moment që humbet orientimin, ose moment krize, kthen krahët dhe duke u shtrenguar njëri pas tjetrit pret të zotin ta rrah me kamxhik.

Lë të shikojmë vetën kujt i ngjajmë. Turmës apo komunitetit. A nuk po i shtrojmë kurrizin politikës për të kaluar politikanët me qëllimet e tyre personale nën emrin tonë?! Sa para shpenzoi Perëndimi për të kultivuar tek ne komunitetin civil dhe vlerat qytetare. Shumë. Ato përfunduan në ushqimin, shtimin dhe fuqizimin e kulçedrës dhe të ujqërve. Rezistenca për të mposhtur qëllimet e mprapshta të politikaneve po dobësohet. Përditë fiton të drejtën e qytetarisë njëriu - individ që për mbijetësë të vetmuar po i përshtatet fytyrës së politikës dhe bashkohet në grup, lëxo turmë, kur ia kërkojnë politikanët që të afirmohen në karrigën e pretenduar.

Panajot Barka Për Frok Çupin. 02.02.2007. POLITIKA

Nga Panajot Barka

Zgjedhjet lokale jasht kontekstit administrativ.

04.02.2007

Zgjedhjet e aferme lokale i janë larguar shumë kontekstit administrativ. Të gjitha parametra kanë fituar një fizionomi thellësisht politike, por brenda logjikës së politikës në vend. Dmth dimesioni kontradiktë është primar dhe tëpër aktiv. Vet koncepti i betejës elektorale për fitore në këto zgjedhje është shndërruar në një “konflikt për jetë a vdekje” midis pozitës dhe opozitës. Ndërkohë, flasim për moment kulmor deformimi të objektivit zgjedhor fillesat e të cilit nisen të paktën që me 1994. Në fakt, “konflikti” i dukshëm në çdo plan ka një komunikim më të drejtpërdrejt me zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut dhe nuk lidhet thjesht me çeshtjen se kush do t’i fitojë këto zgjedhje. Madje as me problemin se si do t’i fitojë. Në një plan të parë duket se opozita është kujtuar të korrigojë deformimin e votës në 3 korrik. Pozita të “konfirmojë” fitorën e arritur me 3 korrik, konfirmim që do ta përdorë si çelësin që do t’i jap mundësi të çojë deri në fund mandatin qëverisës katër vjeçar.

Mirëpo, siç thamë, në këtë përplasje nuk mund të mos vihet re diçka më e rëndësishme se kaq. Këtyre zgjedhjeve u ka renë bara të marrin përsipër promovimin e një klase të re politike që tenton të sfidojë lidshimin e vjetër dhe aktual politik që drejton vendin që me 1991 duke personalizuar dhe klanizuar pushtetin politik dhe mekanizmat e shtetit ose të vëna ato në shërbim të këtyre interesave.

Zgjidhja është e thjeshtë. Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike nga mënyra e votimit deri në numërimin real të çdo vote dhe shpalljen e rezultatit. Porse nuk egziston ky predispozicion të gjithë faktorët, vëçanërisht nderkombëtarët ushtrojnë presion mbi faktorin e brendshëm përgjegjes për to të realizojë zgjedhje të lira dhe demokratike.

E verteta është se qëllimi që i bën edhe këto zgjedhje të rezikuara nuk është më e veshtirë për t’u lëxuar. Madje zhvillimet e tanishme bëjnë lëhtësisht të lëxueshme edhe arsyet e verteta të deformimit të votës në 3 korrik. Flet për këtë deviza politike e kryeministrit. Në çdo takim elektorai ai përsërit se qëllimi i zgjedhjeve për të është të nxjerrë nga politika Edvin Ramën. Rama është kryetar aktual të Partisë Socialiste, i ardhur në këtë post pas humbjes së shitur të zgjedhjeve nga kjo forcë politike në 3 korrik dhe dorëheqjes së Fatos Nanos. Elementi i dytë që i bën të lëxueshëm këtë situatë politike është takimi Nano-Berisha. Fatos Nano duket se nuk e tërhoqi vemendjen nga synimi politik parazgjedhor i 2001. Ai tentoi atëherë të grumbullonte 84 vende në parlament që pas një viti, 2002, të mund të zgjidhej president i vendit. Atëherë nuk ia arriti. Tani duket se synon postin më të lartë për një politikan duke u mbeshtetur te Berisha. Ai me 3 korrik, i dha Berishës pushtetin politik por pa e lëxuar as atë të grumbullojë 84 vende në parlament, fakt që do ta bënte kundërshtarin e tij politik të aftë për të shmangur krizën e presidentit për mandatin e 2007-ës.

Nanua mund të qëndronte pranë forcës së vet politike, të provokonte, për shkak të zgjidhjes së presidentit zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe të vinte kandidaturën për president i propozuar nga forca e vet politike. Nuk e bëri dhe as po e bën këtë jo se nuk ka besim se mund ta propozojë forca e tij politike, por se ka frikë se përsëri nuk do të dalin kartonat në parlament.

Zgjidhja e ofruar nga Berisha është moralisht shumë e kushtueshme, për të dy, por e thjeshtë për t’u zbatuar dhe për të përfutur. Thjeshtësia qëndron te fakti se Nanon president mund ta zgjedh repartit reptësisht të disiplinuar i deputetve të PD-së duke shtuar lëhtësisht aq sa duhen deputet pasues të Nanos në PS. Kjo ka një kosto morale shumë të lartë. Akuzat e ndërsjellta për vite me radhë janë aq të renda dhe ekstreme

saqë çdo bashkëpunim politik midis tyre është i palëjueshëm. Egziston edhe argumenti politik. Ruajtja e stabilitetit të brendshëm politik në kushtet kur Kosova ndodhet në një pikë kthese historike. (!!!)

Në emrin e nevojës për stabilitet politik Berisha mund të rehabilitojë Fatos Nanon deri në krijimin e staturës për president. Ashtu siç po bën. Bashkëpunëtorët dhe pasuesit e Berishës e shikojnë Nanon si Mesian. Kjo do të thotë, minimalisht, për Berishën të kunsumojë pa frikë mandatin katërvjeçar të qëverisjës .

Mirëpo guximi i tyre tregon se ata e kanë humbur sensin e masës në politikë. Nga ana tjetër zbulojnë esencën e paskrupull të politikës në vend. Drama mëgjithatë ka një kulm tëpër tragjik. Votuesi shqiptar në një masë të madhe e pranon sfidën e arrogancës së tyre.

Po ashtu realizimi i kësaj skeme, i kërkon Nanos, përveç lojës me zgjedhjet e 2005 edhe një kusht tjetër. Futjen e PS-së në një amulli politike. Kjo nga njëra anë do të konformojë “domosdoshmërinë historike” të rolit determinant të tyre në drejtimin e vendit. Pra Nanua nuk doli nga politika dhe mburja e Berishës se e nxorri në pension, ishte një mashtrim ngazëllyes për ata që e degjonin. Ashtu si Nanua e mori Berishën e 1997 nga vendi që e kishin hedhur armët dhe dalëngadalë e rehabilitoi gjërsa i dha pushtetin nga i cili personalisht ishte velur, tani i erdhi radha Berishës t’i kthejë reston nga i cili Berisha do të gëzojë pushtetin që as në endërr nuk e bësonte. Pra, Nanua si zakonisht, iku që të rikthehet dhe çdo rikthim i tij shoqërohet me rikonfirmimin politik edhe të Berishës.

Nga ana tjetër risjell në skenë aftësinë e Berishës për të qëverisur jo duke ndërtuar, por duke luftuar kundërshtarin deri në dëshirën finale për të mos pasur fare kundërshtarë.

Pra, PS-ja e mori seriozisht largimin e Nanos pas 3 korrikut 2005 dhe duket se i hyri procesit të shpëtimit nga tutela politike e lidërshiptit të vjetër. Ashtu siç duket se këtë gjë ajo tani duhet ta vuaj. Humbja me çdo kusht në zgjedhje e kryetarit të PS-së që kanditon për kreun e Bashkisë , e realizon maksimalisht këtë qëllim.

Tani ndodhemi serish në të njëjtën situatë. Pozita e sotme e mbeshtetur ose e varur totalisht te i njëjti lidërshipt politik, është në pushtet prej një viti e disa muaj. Brenda kësaj periudhe po vertetohet se ajo nuk tërhiqet nga përpjekjet për të kontrolluar institucionet e pavarura të shtetit dhe për të pasur një opozitë inegzistente. Përsa i përket dobësimin të opozitës, mazhorancës do t’i mjaftonte konsequenca praktike e parullës politike elektorale:- lufta kundër korrupsionit të opozitës dje në qeveri. Mirëpo provat treguan se kjo luftë e bashkoi më fortë opozitën, (edhe pse shpesh për të mbrojtur interesat personale) dhe e bëri me të ashpër luftën ndaj qeverisjës së liderit të mazhorancës së sotme. Nga ana tjetër, mazhoranaca duket se e kuptoi që konsequenca për një kohë të gjatë në këtë luftë do t’i hiqte realisht asaj mundësinë për të përfituar personalisht me të njëjtën mënyrë. Në këto rrethana lideri politik i mazhorancës, duke u nisur nga mënyra e vet e drejtimit, (duke përqendruar në mënyrë absolute në dorën e tij të gjitha kopetencat), shikon si mundësi të vetme dobësimi të opozitës nxjerrjen jashtë loje të liderit të saj E.Rama. Rast më të mirë nuk ka se sa humbja e drejtpërdrejtë e tij në rikadidimin për në krye të bashkisë së kryeqytetit.

Përveç kësaj lideri i mazhorancës, Berisha, ka edhe disa arsye të tjera për ta kthyer këtë betejë elektorale në qëllimin më të lartë politikë të tij. Lideri i sotëm i opozitës, në kuadrin kohor që e drejton atë, ndonëse nuk arriti ta sherojë partinë e tij nga semundjet e renda, pasojë e abuzimit me pushtetin politik të qeverisjës, pati merita në planin anti-Berishë. Arriti ta frenojë ose ta kthejë mbrapshtë atë, pothuajse në të gjitha inkursionet politike në dem të opozitës dhe kontrollit të strukturave të pavarura të shtetit. Ndryshe, pra nga raporti Berisha – Nano ku palet ishin reciprokisht komplementarë, ku Nano i lëshonte Berishës pjesë nga pushteti i tij i pafund i siguruar pas trazirave të 1997, raporti

Rama - Berisha ka në thelb antiberishizmin, në emer të ruajtjes së standarteve në drejtimin e shtetit.

Një humbje e Ramës në luftën për kreun e bashkisë së Tiranës, do të thotë të lëkundet deri në palcë autoriteti i tij në krye të opozitës, autoritet ende i pakonsoliduar dhe me brerje të brendshme serioze. Pra, opozita do t'i rihynte procesit të njohur për rigjetjen "e liderit të padiskutueshëm", fakt që do ta fuste në një rreth vicioz të pafundëm. Drejt këtij synimi Berisha ka me siguri mbeshtetjen e heshtur të faktorit opozitë brenda opozitës, i cili ose ka renë nga fiku, ose ka synime të hapura për të marrë drejtimin e opozitës, ose të posteve të larta shtetërore të cilat arrihen vetëm me ndihmën e Berishës. Zvogëlon gjithashtu premisat lidhur me tezën e hedhur se pas Nanos i vjen radha Berishës për të dalë në pension politik.

Kjo, jo vetëm do ta shpetonte Berishën nga frika e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, aq të përfoluara dhe aq të mundshme, por do t'i siguronte atij zgjatjen e mandatit qeverisës dhe mbi të gjitha një liri të pakontrolluar në drejtimin e vendit dhe të shtetit. Vetëm kështu mund të kuptohet "lufta" e shpallur për marrjen e drejtimit të kryeqytetit.

Berisha e deklaroi i pari dhe që në fillim këtë qëllim. Betejën për Tiranën e shpalli si humbje të domosdoshme të kryetarit të opozitës. E lidhi krizën "vetëm me një njëri" dhe "ky quhet Edvin Rama". E thjeshtoi problemin me nëvojën e këtij të fundit për të "fshehur korrupsionin dhe lidhjet me bandat kriminale".

Por, problemi nuk është aspak kështu. As nuk lidhet thjesht me terrorin verbal të liderit të mazhorancës kundër kundërshtarit politik. As me faktin se Rama ka nga mbrapa një vepër të admirueshme në krye të punëve në kryeqytet që tremb çdo kundërshtar në ballafaqimin me të. Problemi lidhet me shumë me imazhin që krijohet për foshnjërinë e demokracisë në vend që buron nga koncepti i mazhorancës për të drejtuar pa kundërshtarë.

Edvin Rama është lideri i opozitës dhe jo thjeshtë një kryetar bashkie apo një figurë tjetër e çfarëdoshme. Përderisa ai, si lidër i opozitës pranoi sfidën për të pretenduar qëverisjen e bashkisë së Tiranës, mazhoranca duhej të kafshonte buzën dhe në respekt të opozitës të pranonte edhe ajo sfidën. E kundërta është moralisht e denueshme. Në asnjë vend të botës nuk ndodh që një forcë politike, aq me pak mazhornaca, të grumbullojë të gjitha forcat e mundshme, të ligjshme dhe të paligjshme, të ndërshme dhe të pandërshme, me qëllim që të mund kryetarin e forcës politike kundërshtarë, aq me keq kryetarin e opozitës. Përkundrazi, si pozita dhe opozita, atje ku kandidojnë lideret apo dhe figura të tjera të spiktura të secilës forcë, u krijojnë konstruktivitetin e duhur për t'u zgjedhur. E kundërta mund të ndodh atëherë kur janë të domosdoshme premisa për përmbyesje të sistemit politik. Në vendin tonë i kemi të dyja rastet. Në zgjedhjet e para pluraliste në vend, më 31 mars të vitit 1991, Ramiz Alia, numri një i shtetit komunist në vend, "humbi" betejën personale elektorale. (!) Ai e pranoi sfiden se ishte i ndërgjegjshëm se "humbjen" e tij e kërkonte situata politike. Ishte një sinjal se komunizmi e pranoi fundin e tij me një rrugë politike pa shumë gjak. Në zgjedhjet e Korrikut 2005 mazhoranaca e atëhershme i vuri kryetarin të opozitës në Kavajë një kundërshtar, (pa dashur ta fyej) honorifik, për t'i krijuar atij terrenin e duhur për të udhëhequr fushatën elektorale të gjithë opozitës. (Fakt është se opozita e para tre korrikut nuk bëri plotësisht të njëjtën gjë me kryetarin e mazhorancës së atëhershme në zonën e Sarandës)

E keqja tjetër lidhet me faktin se qëllimin politik më të lartë, sipas gjykimit të mazhorancës, ajo kërkoi ta arrijë me çdo kusht e mjet dhe duket se për këtë ka kohë që punon. Nga ana e vet edhe opozita e ka kuptuar lojën e lëxueshme të mazhorancës. Rezistenca e saj në kërkim të standarteve diktohet më shumë nga përvoja se po ndodhi

e keqja askush nuk do të mund ta korrigjojë. Vërrejtjet e ndërkombëtarëve nuk do të kenë vlerë për pasojat e çdo rezultati të manipuluar në jetën e brendshme politike të partive dhe të gjithë vendit. Është pikërishtë kjo përvojë që e mban opozitën të bashkuar. Por dhe thelbi i krizës elektorale që mban faktorin ndërkombëtar të përdorur të kujdesshëm në këmbënguljen e tij për arritjen e standartëve.

Në këtë kuptim defektet ligjore në rregullimin e infrastrukturës zgjedhore, këmbëngulja e opozitës për arritjen e standarteve dhe respektimin praktik të tyre, nuk mund të lidhen thjesht me interesa politike të çastit. As me pamundësinë tonë për të realizuar zgjedhje sipas standarteve evropiane, ose si çdo vend tjetër i parafundit të Ballkanit dhe të Evropës. Lidhen, siç e thamë edhe në fillim, me konceptin e mazhorancës tonë për demokracinë dhe rolin e opozitës në të. 04.02.2007

Nga Panajot Barka

Berisha në rrethim të dyfishtë

03.03.2007/03.03.2007

Berisha ndodhet në një rrethim në shtrengim. Ky përbën lajmin politik të ditës dhe duhet marrë seriozisht në konsideratë. Zgjedhjet e 18 shkurtit i hoqën Berishës të drejtën e pretendimit se gëzon mbeshtetjen e elektoratit. Përkrahja e vetme elektorale i mbeti fshati. Por kjo është një përkrahje që lëxohet lehtë dhe deziluzionon shumë. Fshati shqiptar historikisht pa asnjë lloj lidhjeje me të djathtën dhe për 17 vjet tranzicionin i rreshtuar majtas, papritur, më 18 shkurt voton djathtas. Paradoksi thellohet edhe më po të kemi parasysh se fshat të djathtë nuk ka as në vendet me një bujqësi të zhvilluar e thellësisht kapitaliste. Nga ana tjetër askush nuk mund të kuptojë se si ky fshat i mbetur pa drita, pa përkrahje dhe pa asnjë shpresë zhvillimi, të votojë shkaktarët e kësaj gjendjeje.....

Nuk mjafton vetëm kjo. Berisha mori njëkohësisht vërrejtjen serioze nga Perendimi se me këto palë zgjedhje “i fali” Shqipërisë një rast tjetër të humbur në proceset e saj integruese evropiane. Me këtë rast atij iu mbajt fort dora për ta ndaluar në përpjekjen për një përsëritje, qoftë edhe të sofistikuar, të 1996.

Në një rast të tillë zgjedhja më e mirë për PD-në dhe për vendin do të qe dorëheqja e Berishës. Aq më tepër që me qëndrimet e tij agravuese, destruktive dhe intolerante në fushatën elektorale, u prishi shumë punë kandidatëve të partisës së vet. Por, në rastin e Berishës një kërkesë e tillë përbën utopi.

Në rrethana të tilla i vetmi shans që i mbeti atij është të kapet fort nga pozicioni i drejtuesit të qeverisë. Mirëpo edhe këtu, motivimi i vetëm i saj, antikorrupsioni, dështoi me kohë. Ndërsa reformat e pretenduara përbëjnë një ripërtipje dhe fotokopje të keqe të reformave të socialistëve, të cilat prodhuan sistemin shtetëror të korrupsionit dhe që i denoi ata me humbjen e pushtetit.

Rikonfigurimi që Berisha kërkon t’i bejë qeverisë së tij, përbën aktin me të mirë për të pohuar faktin e humbjes të papranuar deri tash, as publikisht e as zyrtarisht. Në planin logjik kjo është një lëvizje në interpretim të votës “kundër” të shqiptarëve. Në fund të fundit ishte një vot kundër qeverisjes. Mirëpo, po vihet re se Berisha nuk synon ndryshimin e strukturës së qeverisë për një ushtrim efektiv të pushtetit ekzekutiv. Synimi i tij është ruajtja e numrit të votave në parlament në mbeshtetje të qeverisë së tij me synimin tjetër, kapërximin e krizës së zgjedhjes së Presidentit në korrik. Ky rrethim brenda llojit është edhe më i vështirë. Aleatët, me pakicën e vogël bllokuese të Berishës në parlament i kërkojnë atij gjysmën e tortës qeverisese. Kjo ndez në maksimum motoret e zilisë dhe kundërshtitë e pashprehura publikisht brenda kampionit blu. Nga ana tjetër, Berisha duhet të përballojë klanet qeverisese brenda PD-së që për interesat të ngushta përfitimi po ushtrojnë presion për mbajtjen e postëve të tyre. Kjo i pret rrugën çdo përpjekjeje për të sjell në qeverisje personazhë të aftë e cilësor dhe jo vetëm nga shoqëria civile por as nga radhet e PD-së. Është hera e parë që Berisha has në një rezistencë të tillë dhe po tregon se është shumë i dobët. Po ashtu evidentohet me shpëjtësi se figura politike brenda PD-së me integritet politik dhe mbeshtetje të gjerë në publik nuk duan të ndajnë me Berishën faturën e dështimit.

Pra, po vertetohet se në rezistencën e gjatë të opozitës, (kurrorizuar me fitoren në zgjedhjet lokale), për të penguar ritalitarizimin e shtetit nga ana e Berishës, kampi i tij u shkërmoq. Më e rëndësishmja është se klanet dhe grupimet brenda kampit blu janë bërë të fuqishme. Ata edhe pse nuk dalin publikisht nuk ngurojnë të tregojnë dhembët me mënyrat e tyre. Bile, ata nuk tremben as nga kërcenimet e Berishës se do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme, që do të thotë se ata mund të humbasin privilegjet

e pushtetit. Madje, për herë të parë, të gjithë brenda kambit të tij duan që faturën ta lenë në derë të Berishës.

Një situatë e tillë e bën Berishën më të rezervuar dhe më frikësuar në veprimet e tij të mundshme politike pa marrë parasysh vullnetin e opozitës. Ai deshtoi me kohë në diversionet e tij për ta përçarë opozitën. Madje, një përpjekje e tillë, si rasti i takimit me Nanon, iu kthye në bumerang me vlera historike. Opozita veçse është e bashkuar ka treguar se nuk i lëshon më pe Berishës. Ajo tregoi se është e gatshme të shkojë në ekstrem, deri sa e detyron atë të bej prapa.

Mëgjithatë, duket se opozita do të bëhet edhe kësaj here barka e shpëtimit për të. Është e vertetë se ajo ka meritën që brenda një kohe shumë të shkurtër, pas 3 korrikut, edhe pse me shumë probleme të brendshme, arriti, nga njëra anë të vertetojë pandryshueshmërinë e Berishës. Nga ana tjetër të çmitizojë atë. Por, në vijim duket se nuk di ç'të bejë me fitorën. Aq me keq kur kjo evidentohet si tregues se në mënyrë të përseritur nuk është ndërgjesuar për përgjesinë ndaj shumicës së elektoratit dhe për mesazhet që vijnë nga populli (në këtë rast e përdorim termin me terë kuptimin e fjalës). Dihet me ç'farë sakrificave e populli e hoqi nga fronti Berishën me 1997. Opozita ishte atëherë e pa aftë për ta drejtuar popullin në sakrificat e tij. Por, u tregua e tillë kur i rembeu atij suksesin politik duke ardhur në pushtet. Mirëpo nuk u mjaftua me kaq. Dalëngadalë filloi ta ngrejë nga balta Berishën, si mjet për të qëverisur me duar të lira, por edhe të pista. Madje, me vullnetin e vet më 2005, i ktheu përseri pushtetin politik. Tani populli duke i besuar opozitës vendosi ta denojë me mjete demokratike Berishën. Dhe pikërisht në një moment të tillë opozita duket se është e gatshme ta shpërfill vullnetin e shumicës besuar asaj. Pa u shprehur qart opozita ravijëzoi strategjinë politike për të ardhmën e afërm në dy shina. Ristrukturimin e brendshëm të vet për të konsoliduar edhe de jure pozitat në krye të saj lidershipi i ri. Së dyti, konturimin e plotë të taktikave për çmontimin pjesë - pjesë të Berishës. Për këtë fliste së fundi kërkesa e formuluar nga një grup deputetesh të opozitës për heqjen e Berishës nga posti i kryeministrit në këmbim të konsensusit për zgjedhjen e presidentit. Komenti është i tepërt po të kemi parasysh se kjo kërkesë, formulohet në 10-vjetorin e fillimit të trazirave të pranverës së 1997 dhe ngjan si dy pika uji me kërkesën e bërë, po nga kjo opozitë, në fundin e trazirave, kur populli e kishte rezuar Berishën....

Panajot Barka 03.03.2007 U botua po atë ditë.

Nga Panajot Barka

Marshe të ndryshkura nuk duhet të “ndryshkin” marrëdhëniet

Shqipëri Greqi.

09.03.2007

Rast pas rasti e përherë e me shumë po vertetohet se institucione që kanë marrë përsipër të përpunojnë opinionin publik dhe sjelljen kolektive të shoqërisë, si edhe institucione të drejtimit politik të vendit, po futen në krizë duke mos i nxënë më as streha e fundit, ajo e nacionalizmit.

Ngjarja e fundit, që flet për këtë, është reagimi në lidhje me marshin stervitor të një grupi ushtarësh të “X”(!) strukture ushtarake greke. Nuk ka asnjë dyshim që përmbajtja e vargjeve të tij është e denueshme. Por, është një rast sporadik dhe jo fenomen. Kjo duhet shënuar. Ashtu siç duhet shënuar fakti që, në fillim të viteve '80 me vendim të posaçëm dhe pavarësisht nga reagimet e kohës, qeveria greke ndaloi përdorimin në ushtri të marsheve rreshtorë dhe stërvitorë me përmbajtje nacionaliste ndaj fqinjëve dhe këngëve të kësaj natyre në institucione zyrtare që kishin të bënim me brezin e ri.

Nga ana tjetër, një historian sado i rendomtë, nga të shumtët që pamë ditët e fundit në medjat e Tiranës, në një analizë fare të vogël do të kuptonte se bëhet fjalë për një marsh tëpër të vjetër, që lidhet me së shumti me ngjarjet e dhetëvjeçarit të parë ose të dytë të shekullit të kaluar.

Në këto rrethana zbulimi i një episodi të tillë, të ngritur në internet, rondon mbi mbartësit e tij, të cilët me këtë rast, lenë për vete çdo hapësirë për çdo epitete anakronik. Ashtu siç kthehet në bumerang për të gjithë ata që kërkojnë ta paraqesin atë si mentelitet të strukturave ushtarake apo dhe të shoqërisë greke dhe me këtë argument kërkojnë të mbajnë gjallë, apo të ndezin më shumë, ndjenjën e nacionalizmit të semurë dhe anakronik në Shqipëri.

E çuditshme është se brenda harkut kohor të disa muajve po përseriten situata të njëjta, të cilat edhe pse nuk duhet të kenë asnjë akses në opinionin publik, po përdoren për manipulimin nacionalist të tij me “kundërshtar” Greqinë. Pra, duket se nacionalizmi komunist ushqen ende me forcë nacionalizmin e segmenteve të caktuara deri në hierarkinë shtetërore, se “armiku-Greqi” mund të përdoret si mjet efektiv për forcuar ndjenjën kombëtare shqiptare dhe për të kapërxyer çdo lloj krize tjetër të brendshme. Kështu në maj-qërshor të vitit të kaluar “plasi skandali” me eshtra të vdekurish në Kosinë të Permetit. Të njëjtat struktura harruan atëherë parimin e konsideruar si pikënisje të vet qyteterimit. Se mbrojtja e të vdekurve, e varreve dhe e kujtimit të tyre, përbën parimet bazë për të paqtuar, rregulluar, emancipuar jetën e atyre që janë mbi tokë. Këto segmente ngritën dhe mbajtën në këmbë një fushatë të shfrenuar antigreke, duke ricikluar për një kohë të gjatë të gjitha “njollat e murme të marrëdhnjeve” shqiptaro greke, madje duke kërkuar që këto “njolla” të përcaktojnë dhe rendin aktual të ditës së këtyre marrëdhnjeve. Pra, trazuesit e eshtrave atëherë duheshin denuar në mënyrë shëmbullore, por pa trazuar opinionin publik dhe pa provokuar marrëdhënjet midis dy vendeve. Një qëndrim të njëjtë imponon matura e institucionëve publikë e shtetërore të një shoqërie të civilizuar edhe rasti konkret i marshit të ndryshkur të një grupi anonim ushtaresh grek.

Në të dyja rastet, ashtu dhe në shumë të tjera, heshtja e institucionëve të ngjashme greke, nuk ishte tregues “i fajit”, por i maturisë së kërkuar në të tilla raste. Në rast të çdo qëndrimi tjetër ato do t'i kundërviheshin misionit të vet për të parë para dhe jo mbrapa. Ta zemë se nga pala greke do të përdorej e njëjta monedhë. Përcilleshin opinionit publik grek imazhet me hollësi të skajshme me djegjen e flamurit kombëtar të Greqisë, ç' do

të ndodhte. Më së paku, një reagim negativ në proceset integruese të emigrantëve shqiptarë në shoqërinë Greke, shtimi i kalvarit të procesëve legalizuese të tyre, ftohje në marrëdhënjet midis dy vendeve etj. Kush do të dilte i fituar!?

Në këtë skemë nacionalizmi shqiptar, i shfaqur si antigreqizëm, vihet re se flamurin e mbajnë mjetet e komunikimit masiv me protagonist disa medja të shkruara dhe elektronike. Ato e bëjnë me zell këtë punë duke shkelur edhe mbi parimet bazë të profesionalizmit. Ndryshe nuk ka pse dalin në ekstreme propagandistike duke paraqitur si “protesta masive” dhe lajme sesacionale “të një kënaqësie të vëçantë” faktin se një grup i vogël njërëzish, shpesh me pak se dhjetë veta, djegin në “shenjë proteste” në ambjente publike të qyteteve shqiptare flamurin kombëtar të Greqisë, ndërkohë që disa dhjetra të tjerë rrinë të distancuar.(!!). Ose, u japin mikrofonin njërëzve anonim për të folur në emrin e të gjithë popullit etj. Këto medja edhe institucione të tjera pas tyre edhe pse dështuan disa herë për të nxjerrë në “protesta masive” shqiptaret kundër Greqisë, nuk dorëzohen. Po ashtu, ky fakt, bashkë me atë që shqiptarët e thjeshtë nuk i dëgjojnë, as këta, as politikanët, për të dalë në protesta edhe kur u mungon uji, drita, apo buka, tregon se nuk gëzojnë respektin e mbeshtetjen e tyre.

Në këtë rol nuk mund të mos vihet re se ata marrin përsipër të përfaqësojnë strukturat e shtetit, ose të jenë ana e pasme e tij. Në të dy rastet e përmendura medja e pafuqishme në angazhimet e tyre “nacionaliste” të niveleve kaq të ulta, kërkuan ndihmën e shtetit. Detyruan ministrinë e Mbrojtjes të dalë me një deklaratë, parlamentin dhe komisionin e tij të jashtëm të marrë poza të mbrojtjes së dinjitetit kombëtar. (Në të dyja rastet kishim të bënim me përmbajtje që ngjasonin shumë me ndryshkun e vargjeve të marshit rreshtor të ushtarëve grek. Ndërsa, nga ana tjetër, parlamenti nuk mirret dot me analizën e skandalit të zgjedhjeve lokale që e fyejnë realisht dinjitetin kombëtar të Shqipërisë !) Por, strukturat e shteti marrin edhe vet përsipër rol në situata të tilla. Ndryshe nuk mund të kuptohet fakti që në vende publike, forcat e rendit lëjojnë djegjen e simbolëve kombëtare të një shteti fqinj. Madje, veprime të tilla lëjohen edhe në qytete të tilla si Saranda me prani të konsiderueshme të grekeve etnik. A nuk përbën kjo një shkelje flagrante të të drejtave të minoritetëve dhe një fyerje publike etnike të shumicës mbi pakicën të lëjuar nga shteti dhe të publikuar nga medjat? (Aq me keq kur njoftimet “për protesta në sarandë” e kishin origjinën te drejtuesit e medjave shtetërore.) . Në fund të skemës qëndron njërëziteti dhe thjeshtë, të cilët edhe pse nën presionin e jashtëzakonshëm të këtyre strukturave me peshë të fuqishme, nuk jipen, e kanë kuptuar hilenë se këto lojra u shërbëjnë atyre dhe kohës së shkuar që ata përfaqësojnë, ndaj dhe nuk u shkojnë nga pas.

Së fundmi, një situatë e tillë nuk është pa pasoja. Më të rënda kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis dy popujve dhe vendeve fqinjë, që kaq shumë gjëra i bashkojnë. Por, më shumë sjellin si pasojë marginalizimin e minoritetit etnik në Shqipëri. Dhe kjo, sado që të dëgjohet ireal, është shumë e rrezikshëm, aq me tëpër që shteti shqiptar nuk ka menduar dhe nuk po mendon që të përcaktojë dhe të realizojë statusin e këtij minoriteti në shoqërinë e shtetit shqiptar.

Panajot Barka 09.03.2007 Për Gaz POLITIKA

Nga Panajot Barka

Topi –president, çimentim i pushtetit të Berishës.

22.03.2007

Berisha kërkon rol primat në politikën e pas zgjedhjeve lokale të vendit. Nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Është thjeshtë një rikonfirmim i pandryshusmerisë së tij. Roli që kërkon Berisha është brenda logjikës së tij të kontrollit të gjithçakeje dhe ka të bejë me imponim kushtesh ndaj gjithë faktorit tjetër politik në vend.

Formula është e thjeshtë. O Bamir Topin president, o zgjedhje të parakohshme. Kjo formulë, pikë së pari, shmang në themel gjenë më kryesore që kërkohet për momentin politik. Konsensusi midis palëve të politikës për mandatin e ri të presidentit. Nga ana tjetër edhe pse kushtet e tij i ngjajnë fjalës së urtë popullore me atë që hedh një gurë në lum dhe vrapojnë pastaj nja 20 të mençëm për ta nxjerrë, përbëjnë një demarsh që synon të neutralizojë aksionin për ta nxjerrë atë në pension politik, si domosdoshmëri objektive e shtruar për zgjidhje për të djathtën në vend dhe për terësinë e politikës shqiptare.

Në këtë kontekst Bamir Topi përbën për Berishën një rrezik eventual. Propozimi i postit të Presidentit të Republikës, është në fakt një heqje qafe nga ana e Berishës të sfiduesit të tij kryesor. Kjo është e vlefshme edhe pse dihet se zgjedhja e Topit President është tepër e veshtirë për t'u arritur. Sikur B. Topi të zgjidhet president, Berisha nuk do të jetë i kënaqur vetëm se nuk do ta këtë kërcenim për ta zëvendësuar në parti dhe në qeveri. Është totalisht i bindur se, pavarësisht nga marrëzitë e tij në drejtimin e vendit si kryeministër, ai, Topi-President, do t'i mbulojë prapësitë dhe do ta ndihmojë në arritjen e qëllimeve të tij për të kontrolluar institucionet shtërore, (rasti i kryeprokurorit, rinovimi i mandatit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë etj).

Po ashtu, Berisha ka të drejtë të shpresojë se në kushtet kur faktori perendimor është në unison pro pamundësisë së zhvillimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ai mund t'i imponohet opozitës për konsensus për zgjedhjen e presidentit. Ose, në rast të kundërt, për “blerjen” e votova të munguara, ose me para, ose duke kërcënuar atë kategori deputetesh nga opozita, të cilët në rast zgjedhjesh të parakohshme nuk kanë asnjë mundësi për t'u rizgjedhur deputet.

Nuk përjashtohet mundësia që ekspozimi me “kokëfortësi të pakthyeshme” i kandidaturës së Topit për President të përdoret nga Berisha si një “As në mengë” që në rast kompromisi me të majtën të këtë ai të drejtë t'i imponojë së majtës emrin alternativ për president. Ky mund të jetë nga e majta dhe konkretisht Fatos Nano. (Berisha duhet të mbajë fjalën për t'i kthyer Nanos borxhin e dorëzimit nga ky i fundit të pushtetit me 3 korrik 2005)

Zgjidhja e kundërt, dmth zgjedhjet e parakohshme. Berisha i shton kësaj alternative një shtojcë. Zgjedhje të parakohshme me kodin elektoral të vjetër, bile pa marrë parasysh as ndryshimet e imponuara në janar 2007.

Në kushtet e tilla Berisha është i bindur se i rifiton zgjedhjet e parakohshme dhe i shton vetës mandatin e kryeministrit nga 2009 në 2011. Opozita tregoi në zgjedhjet lokale se nuk mund të kontrollojë dhe të mbrojë votën në të gjithë territorin e vendit. P.sh fshati, baza elektorale e së majtës, mund të bëhet edhe një herë varmihësi politik i saj.

Nga ana tjetër, imponim i zgjedhjeve me logjikën e faktit të kryer, do të detyrojë të gjithë faktorët brenda PD-së të “rreshtohen” pa asnjë medysheje nën urdhërat e tij me qëllim të vetëm të mos humbasin pushtetin. Kjo do të thotë se jo vetëm Bamir Topit do t'i heq çdo të drejtë morale për të pretenduar rol në punët e PD-së dhe të pushtetit, por, ta zemë, as të Jozefina Topallit. Zonja Topalli, e cila mund të ferkojë duart që Berisha, me propozimin e Topit për president i heq nga rruga e ambicjeve për në krye të PD-së

një kundërshtar të fuqishëm, (kjo e bën aleate të ngushtë me Berishën) në rast të një procesi zgjedhor të parakohshëm nuk do të guxojë të shpalos synimet e veta. (Nga ana tjetër, prania e Topit si pretendent për kreun e PD-së, kuptohet në rast se kushtet janë të tilla që të imponojnë një dorëheqje të sigurt të Berishës, i heq Topallit mundësinë për të pretenduar gjithë partinë dhe ajo nuk do të parapëlqente të trashëgonte pjesën natyrale, ta quajmë berishiane, në PD)

Kushti zgjedhje të parakohshme që manifeston tani me forcë Berisha, duket se i heq iniciativën politike opozitës, e cila shikonte momentin e zgjedhjes së presidentit si alternativë të vetme për të riardhur në pushtet. Në fakt opozita tregon se nuk di të administrojë politikisht fitorën në zgjedhjet lokale. (Në një kohë që Berisha po e përdorë humbjen dhe qëndrimet e paradokohshme të opozitës për të përforcuar pozicionet e tij të lëkundura nga keqadministrimi i pushtetit ekzekutiv).

Ajo, opozita, tregon se në përpjekjen e saj për të fituar kredibilitet politik tek faktori ndërkombëtar, zgjodhi si alternativ politikë (dhe jo në unison) propozimin e një pakete reformash, ku në qëndër të vemendjës është ajo zgjedhore.

Një lëvizje e tillë duket se e çmobilizoi akoma me shumë opozitën në pikësynimet e veta për pushtetin. Duket qartë se nga njëra anë po lëkund unitetin e partive të opozitës së bashkuar. Nga ana tjetër, brenda partisë më të madhe të opozitës, PS-së, fitorja në zgjedhjet lokale dhe aq me shumë ajo e kryetarit të saj në Tiranë, nuk po kthehet në një proces konsolidimi të lidershit dhe të strukturave të tjera brenda saj. Përkundrazi, qëndrimet e fundit në parlament, me votat pro ministrave të qeverisë, nuk flet vetëm për mungesë serioziteti. Flet me shumë për çekulibrim në marrëdhëniet e drejtimit politik në kampin e opozitës, por edhe për një farë sharlatanizëm e papërgjeshmerie politike në strukturat e saj. (Shumë nga deputetet e opozitës tregojnë se u intereson amullia politike që ata të gëzojnë ato që fituan në kohën që ishin në pushtet). Tek kjo lloj “kalbjeje” në opozitë duket se beson çdo ditë e me shumë Berisha.

Pra, në thelb politika shqiptare është në një udhëkryq krize në thellim të cilën e paguajnë rendë qytetarët e thjeshtë. Javët në vijim duket se do të promovojnë një përplasje edhe më të madhe dhe do të evidentojnë dhe imponojnë si zgjidhje të vetme:- Dorëheqjen e kryeministrit Sali Berisha, krijimin e një qeverie teknike, për të realizuar të paktën reformën zgjedhore, zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme me standarte ligjore të garantuara.

Një zhvillim i tillë është e sigurt që do t’u hap rrugën edhe proceseve reformuese në të dy kampet e politikës dhe do t’i çlirojë ato nga ato mënyra totalitariste drejtimi e nga interesa që helmojnë gjithë jetën politike në vend, përparimin e tij dhe proceset integruuese evropiane.

Panajot Barka për gaz.Politika 22.03.2007

Nga Panajot Barka

Politika ushqen krimin nëpërmjet shtetit.

06.04.2007

Eqrem Bej Vlora në librin e tij “Kujtime”, i cili me të drejtë mund të vlerësohet se arrin t’i bej një skanim shoqërisë shqiptare të periudhës 1885-1925 me vlera të pakontestueshme për perspektivën aktuale, midis të tjerash tërheq edhe dy konkluzione të cilave u referohemi për këtë fillim shkrimi:

Duke iu referuar historisë së disa njërëzve në Shqipëri, të cilët shoqëria i bëri të shquar E. Vlora thotë se, “mjafton një plumb pas shpine dhe të bën njëri të madh”. (Në librin e tij ka shembuj tronditës se si një vrasës i paguar është kthyer në hero) Po në lidhje me këtë sjell një shembull se si një bandë hajdutësh u kthye në roje heroike të qeverisë së Vlorës... (Viti i mbrapshtë 1997 ishte i pamatë në të korra të tilla). Është e vertetë se në të gjitha shoqëritë njërëzit të aftë për të kryer krime gëzojnë respektin e atyre strukturave shoqërore madje edhe shtetërore që kanë lidhje me botën e krimit apo të luftës kundër tij. Mirëpo në kësi rastësh këta njërëz ose zhduken apo vdesin pa u marrë vesh, ose përfundojnë në burg. Por kurrën e kurrës nuk shpallen heronj, ose nuk u besohet drejtimi politik i vendit, me përjashtim të rastëve kur kemi të bejmë me sisteme gjakatare.

Konkluzioni i dytë. Është i lidhur ngushtë me të parin dhe ka të bej me aspektin politik dhe drejtimin e shtetit. E. Vlora përcakton faktorin e brendshëm politik se njeh “vetëm përkatësinë fisnore dhe varësinë ndaj një “të fuqishmi” (i përcaktuar ky si më lart). Në vijim na thotë se kur nuk plotësohen interesat personale të politikanëve ata janë gati të shkatërojnë vendin (ashtu si në rastin që për t’i kënaqur ato, shpallin luftë në emer të interesave të atdheut). Nga nëntori i 1920 deri në dhejtor të 1921, thotë E. Vlora, u ndëruan 6 qeveri, jo se ato nuk i përgjigjeshin vullnetit të popullit, por se kështu e kërkonin interesat e grupëve.

Lë të mundohemi të aktualizojmë konkluzionin e parë. Sa herë kemi dëgjuar dhe parë fakte se si politikanë, drejtues partish, deputetë, ministra, akuzohen hapur për vjedhje, korrupsion, trafiqe njërëzish, armesh, droge, votash. Sa herë kemi parë dhe vertetuar se ky lloj krimi ekonomik, shoqëror e politik, (ndryshe i organizuar) lulëzon në bazë rrathësh gjaku dhe zinxhirë të pafund vrasjesh.

Konkluzioni. Lufta për kontrollin e pushteti politik dhe ligjet e shtetit synojnë thjesht të ushqejnë, të mbajnë në këmbë dhe të forcojnë këto struktura krimi. Para disa muajsh, në kulmin e përplasjes midis pozitës dhe opozitës për sistemin zgjedhor, deputetet e të dy krahëve në parlament gjetën lehtësisht gjuhën e përbashkët për të mënjnuar kontrollin parlamentar në lidhje me zullumet e tyre.

Të njëjtën gjë po verteton tani rivlerësimi i zhvillimeve të 1997. Vendi u dogj nga politikanët që të mbuloheshin krimet e politikanëve. Sot drejtojnë vendin ideatorët dhe ekzekutorët e krimit të piramidave të 96-97, përgjegjësit kryesorë të krimit të shkatërrimit të shtetit me 1997, organizatorët e grushtit të shtetit me 1998. Ky konkluzion ka në dispozicion fakte edhe më tronditëse po të kemi parasysh qëllimet e verteta të thyerjes së embargos së OKB-së ndaj ish Jugosllavisë në mesin e viteve ‘90 nga e njëjta kupolë qeverisëse sot dhe pasojat reale, në rafshin etnik, nga ky veprim.

Po ashtu, çdo ditë që kalon po verteton katërcipërisht se këmbimi i pushtetit më 2005, u bë “në rrugë paqësore” brenda kornizës së marrëveshjes për fshehjen apo faljen e krimit të ish qeveritarëve. Kjo u arrit në saj të realizimit të një krimi tjetër të rendë, manipulimin e votës për të trafikuar pushtetin politik.

Lë ta shikojmë problemin në një aspekt tjetër. Kohët e fundit, vlërat e trashëguara që përbejnë themelin identifikues të një shoqërie fituan te ne një mjet këmbimi të vetëm:-paranë. Politika e ngriti shumë lartë stekën e fitimit të parasë. Kjo do të thotë se të bëhesh pjesë e politikës, psh depurtet, (kuptohet me synim të bëhesh i pasur) të duhen shumë para. (Të paguash shtrenjtë ata që do të japin të drejtë të kandidatosh dhe në vijim ata që do të votojnë.) Por që t'i japësh ato para duhet t'i kesh dhe bile t'i kesh pa djesë. Dmth, të jenë të pista, pra me originë krimin. Dhe që t'i shtosh ato para duhet t'u shërbesh, duke u krijuar mburojë politike, strukturave të krimit.

E.Vlora, brenda kësaj analize, nuk mbeti thjesht tek konstatimi i njohur se çdo popull meriton qëverisjen që ka. Ai vuri re se himnizimi i figurave të inkriminuara dhe delegimi te ta i rolit udhëheqës, lidhet me kthimin në mentalitet përmanent shoqëror që rrjedh, ose është pasojë e krijimit të strukturave të tilla të trashëguara dhe të qëndrueshme nga e kaluara. (Një rast tipik përbën gadishmëria e medjës disa javë më parë për të kthyer në "heronj" djegësit e flamurit kombëtar të Greqisë) E. Vlora vë re se si figurat e ardhura në drejtimin e shtetit të ri shqiptar pas shembjes së perandorisë otomane, ishin po ato figura që kishin kontribuar nëpërmjet intrigave politike dhe krimit për mbajtjen në këmbë të pushtetit të kësaj perandorisë, shpesh në dem të vet shqiptarëve apo dhe të popujve të tjerë. Ai verteton se edhe burrat e shtetit komunist si E. Hoxha, Mehmet Shehu, Hysni Kapo etj rridhnin nga familje që nuk mund ta përceptonin ekzistencën e tyre jasht Turqisë, që do të thotë, (ashtu si u vertetua) se gjenetika e tyre politike përbente një vijimësi të atij mentaliteti. Po ashtu periudha post komuniste te ne vazhdon të drejtohet nga pinjollë të kultivuar në struktura e shtetit feudokomunist. Ose të njëjtat klane qëverisese të mentalitetit feudokomunist shqiptar vazhdojnë të drejtojnë edhe sot vendin, hapur ose të fshehur, pas lidhjeve të drejtpërdrejta gjaku, krushqie apo interesash.

Lë të vijmë tani te momenti tjetër. Te gadishmeria absolute e njërezve të politikës për të lenë pas vetës tokë të djegur nëse u rrezikohen interesat personale apo të grupit. Në të gjitha rastet do të mjaftonte shëmbulli i 97-ës, për të cilin do të thoshnim se përseritja dhe përjetimi në forma të ndryshme të tij në vijimësi edhe pas dhjetë vjetësh, na detyron të mos i dëgjojmë thirrjet që ajo pranverë e zezë të harrohet njëherë e përgjithmonë. Marrim si shembull të parë kryministrin aktual. Ai po humbet rastin për rehabilitim historik pas dëbimit me armë nga populli më 1997. Me sjelljen e tij po shkallmon shansin e fituar (pavarësisht se si) me 2005 të kthimit me votë në pushtet nga i njëjti popull. Nëvoja për largimin e tij nga pushteti vertet mund të administrohet historikisht si detyrë patriotike. Këtë ai e ka kuptuar dhe nxiton për të përfituar sa më shumë për vete dhe klanin e tij, por edhe për të lenë nga prapa tokë të djegur. Ai po përdorë, duke i kopjuar me fanatizëm të egër, të njëjta metoda përdorimi të shtetit për përfitim personal e klanor, të përdorura nga paraardhësit e tij. (Lë të mos harrojmë se ishte kjo mënyrë qëverisjeje e të majtëve që e çoi zhgënjimin dhe humbjen shpresës së votuesit shqiptar më tutje se egërsia e qëverisjës së parë të Berishës 92-97). Sa më shumë thirrjet dhe presionet për largimin e tij po shtohen aq më intensivisht gjejnë gjuhën e përbashkët nëvoja për të fituar dhe për të lenë nga pas tokë të djegur. Madje këto dy gjëra kompensojnë njëra tjetrën dhe lidhen me raportet e deformatuara e të vëna re nga E. Vlora, midis përkatësisë fisnore dhe varësisë ndaj një "të fuqishmit". Tokë e djegur në ngritjen e shtetit ligjor, tokë e djegur brenda në PD. (Po plotësohen të gjitha premisat që me ikjen e tij, partia në pushtet të përçahet, të behet tokë e djegur). Në tokë të djegur synon të kthejë edhe opozitën për të mos pasur mundësi të marrë pushtetin. Tani sulmi është përqëndruar mbi medjën që do të thotë cenim të fjalës së lirë. Kështu pas vjedhjes së votës kjo do të thotë tokë e djegur për vetë demokracinë, pavarësisht se kryeministri thotë me cinizëm se ajo funksionon.

Opozita, e cila kurrë nuk ka ditur të marrë pushtetin, por e ka përfituar atë nga zëmërimi popullor ndaj ekstremizmave të Berishës (dhe e velur nga keqmanaxhimi i tij di ta dorëzojë “në paqe dhe urti”) është përfshirë edhe ajo në procese të tokës së djegur pasi interesat e njëshave brenda saj nuk plotësohen. Njëshi tradicional në PS kërkon kreun e shtetit dhe për këtë është gati (bile po ta dojë nëvoja të blejë me çdo çmim nga paratë e vjedhura, votat e duhura deputetesh), të shkatërrojë:-tokë të djegur,- opozitën. Atij nuk i intereson marrja e pushtetit nga partia e tij, para pushtetit të tij. (Eshtë gjithashtu një rast i ri për të provuar se ai është i pazëvendësueshëm.)

Lideri i ri i opozitës ende pa provuar shijet e të qenit fitimtar, provon sfidën e përçarjës me akuzën se po e shndërron partinë në favor të interesave të një klani të caktuar. Në këto rrethana ai bashkë me përpjekjet për të konsoliduar pozicionin e tij të liderit, përgatitet për të ikur duke lenë nga pas tokë të djegur, përçarjën e re të radhës.

Të njëjtën strategji dhe gati për veprim kanë në skutat e padukshme të ndërgjegjës politike edhe liderat e tjerë të partive të vegjel....

Kështu që problemi shtrohet se kush do ta përgënjeshtrojë E.Bej Vlorën...!?

Panajot Barka për gaz. Politika 06.04.2007

foli për të drejtat e njëriut sipas konventës kuadër etj. Se pa që nga deklarata e tij u distancuan me radhë deputeti i zonës Peçi, sekretari i përgjithshëm i PBDNJ-së, Solis dhe (nën zë) kryetari OMONIAS, Jani. Pse zgjodhi mjete publike periferike dhe jo zyrtarisht apo në medjat që abuzuan me të. Pra, nesë është i vertetë fakti i abuzimit me deklaratën e tij bëhet edhe më e çuditshme heshtja e tij ndërkohë që marrin dhenë reagime dhe qëndrime të ashpra të politikës dhe të opinionit publik shqiptar. Aq me keq që në qëndër të vemendjës së këtyre reagimeve nuk është thjeshtë Bollano, por gjithë minoriteti grek, historia, të drejtat dhe realiteti i tij, si dhe strukturat politike përfaqësuese të tij në Shqipëri. Vihet në qëndër të vemendjës Greqia për të cilën të gjitha qarqet nacionaliste në Shqipëri “gjejnë” në këtë deklaratë një argument më shumë “për të provuar armiqësinë greke ndaj Shqipërisë”. Pra, kemi kulmimin e një stuhie të re antigreke. Në të përfshihen opinioni publik Shqiptar. (Vetëm në ditën e parë pas publikimit të deklaratës, në *site*-n “Forum” në internet janë regjistruar mbi 145 reagime, me dhe pa emer, por me qëndrime nga më ekstreme ndaj çdo gjëje greke. **Këtu qëndron edhe dallimi i madhë me situatën e krijuar më 1994**). Përfshihen segmente të politikës deri te parlamenti. Në reagimet e tyre vihet re e njëjta gjatësi vale me publikun anonim, pavarësisht nga elokuenca e tyre politike.

Por për çudi, në këtë “stuhi” nuk përfshihen strukturat kopetente shtetërore për të vertetuar realitetin e kësaj deklarate dhe për të marrë masat e duhura. Aq më tepër kur shikohet që, qoftë si “shashkë”, qoftë si “e vertetë” ajo po shndërrohet në një alkimi e keqe që çon në margjinalizimin e minoritetit grek në Shqipëri dhe ç’integrimin e tij nga shoqëria shqiptare. Kthehet në një proces demonizimi të këtij minoriteti dhe Greqisë në mjedisin shqiptar. Madje, në funksion të këtij qëllimi frymëzuesit e tij nuk pranojnë të venë re se midis konceptit “pavarësi” (të Kosovës) dhe “autonomi” (të Vorio Epirit) nuk ka asnjë ngjashmëri. Gjithashtu, nuk mund të mos vihet se ndërsa synohet që “deklarata” e Bollanos të konsiderohet si një përpjekje për të venë shkopinë nën rrota procesëve në Kosovë, qëllimi i vertetë është defaktorizimi etnik dhe politik i minoritetit grek në Shqipëri përballë shumëfishimit të energjive për promovimin e “problemit çam” dhe paralelizmit me këtë minoritet, realitete që në fakt nuk kanë asnjë lidhje.

Po ashtu sjelljet e fundit politike të Bollanos ngrenë edhe një pikëçuditje tjetër. Pas fitimit të mandatit të parë, ai nuk guxonte të pranonte në publikun shqiptar përkatësinë greke për vete dhe për komunitetin e Himarës. Fillimin e fushatës së tanishme elektorale ai e nisi me sjellje totalisht të kundërta dhe e përfundoi fushatën duke falënderuar Berishën për fitorën e tij.

Pikëpyetja tjetër lidhet me faktin që qëndrimin e vet Bollano e transmeton si qëndrim të OMONIAS. Ajo, që nga koha e krijimit si përfaqësues politik i minoritetit etnik grek në Shqipëri, kurrë nuk ka mbeshtetur në mënyrë zyrtare qëndrime që Bollano kërkon t’i atribujë me deklaratën e vet.

Kështu, në fillim të 1992, OMONIA nuk zyrtarizoi deklaratën e deputetëve të vet në parlament, deklaratë e cila thoshte që në rast se OMONIA nuk do të pranohej si subjekt elektoral për zgjedhjet e marsit 1992, atëherë minoriteti grek do të ishte i detyruar të kërkonte rishikimin e statusit të tij në Shqipëri. Po ashtu në Konferencën e OMONIAS të 10 prillit të 1994, rra në heshtje kërkesa e një grupi delegatesh, që eksponentë të OMONIAS, para se të bënin publike dhe në emer të saj, pikëpamjet personale për “autonomi”, t’i shtronin ato për aprovim në organin më të lart vendimarrës të organizatës, ashtu siç parashikon statuti i saj. Në fillim të 1999-ës, vet Bollano, i porsa ardhur në udhëheqjen e OMONIAS, u rreshtua kundra një deklarate të Këshillit të Përgjithshëm të saj, edhe pse ishte në përgjigje të deklaratës së presidentit Klinton për barasvlerë të të drejtave të njëriut në Kosovë dhe të minoritetit grek në Shqipëri. (!!!)

Në këtë pikë tërheqim vemendjen duke theksuar se do të ishte në nderin e Bollanos, apo të cilitdo tjetër, që para se të konsumonte në publik qëndrime të tilla, të luftonte, që, duke respektuar kushtetutën e vendit dhe aktet ndërkombëtare, ato të bëheshin teza programore të OMONIAS dhe të PBDNJ-së. Tani ato janë thjeshtë abuzive dhe kundër interesave të vet minoritetit. Aq më tepër që institucionet përfaqësuese të minoritetit grek edhe pse po bejnë dhjetë vjet në pushtet nuk janë në gjendje të detyrojnë qeveritë shqiptare t'u sigurojnë femijve minoritarë në shkollat publike në gjuhën amtare, tekstet në gjuhën e tyre.

I meshojmë kësaj ideje se edhe sot, pas kaq vitesh, nuk mund të mos vemë në dukje se si zanafillë e gjithçkaje të zezë në jetën e minoritetin grek në pluralizmin shqiptar, (të cilën e evokoi nga e kundërta kanali televiziv Top Channel), ishte një deklaratë personale i një drejtuesi lokal të OMONIAS në një gazetë provinciale dhe krejt anonime të Greqisë. Edhe ajo deklaratë thoshte se gjoja OMONIA, atëherë në një moshë fare të re, “luftonte për bashkimin e Vorio Epirit me Greqinë”.(!!!) Deklarata u bë publike me shumë shpëjtësi dhe në nivele të larta, pak para se parlamenti shqiptar të vendoste për fatin e OMONIAS për të qenë ose jo subjekt elektoral. Deputetet e OMONIAS u thirren me urgjencë në ambasadën amerikane dhe iu kërkua të distancohen nga një deklaratë e tillë. Distancimi ndodhi po atë ditë në sallën e parlamentit edhe pse pritej e kundërta. Megjithatë asgjë nuk ndryshoi në unitetin parlamentar midis së majtës dhe të djathtës, të krijuar pas publikimit të deklaratës. OMONIA u quajt “kal troje i Greqisë”.

E vertetë është gjithashtu se për të gjithë veprimtarinë “nacionaliste” të grupit të atëhershëm në udhëheqje të OMONIAS, strukturat kopetente të shtetit shqiptar kishin informacion të plotë. Mëgjithatë “udhëheqësve” nuk u hynte gjemb në kembë, ndërsa minoritarët e thjeshtë që u shkonin nga pas, hanin shkopinj e gomës. Po ashtu, për evidentimin e “nacionalizmit” të minoriteti grek dhe të vet Greqisë, ishte shpesh e domosdoshme edhe sakrifica shqiptare. Në incidentin e Peshkëpisë, p.sh, nuk duhen harruar faktet e sjella nga hetimi. Në kundërshtim me ligjin, rekrutet u çuan në kufi para se të kryenin betimin luftarak. Rrjedhimisht nuk u lëjohej përdorimi i armëve luftarake. Po ashtu reparti i Peshkëpisë ku ata u instaluan ishte pa ndërlidhje me qëndrën dhe fletët e procesverbaleve të ditëve para incidentit mungojnë.

Si përfundim, rezultati i provuar në praktikë është se kjo veprimtari “nacionaliste” i dha “të drejtën” shtetit të përballojë masën masën e minoritetit grek në marrëdhënie dhune të njëanshme. Rrugëdalja e vetme për të ishte ikja drejt Greqisë. Statistikat tregojnë se numri i anëtarëve të minoriteti grek që morën rrugën e migrimit drejt Greqisë gjatë kësaj periudhe është pothuaj dyfishi i numrit të atyre që u larguan pas vendosjes së kufijve. (për periudhën 1912-1945 numrin është rreth 20 mijë veta) Madje në dallim nga periudha e atëhershme që iknin vetëm burrat, tani flitet jo për emigracion por për ikje kolektive e familjare.

Ndërkohë, disa nga këta “drejtues nationalist” të OMONIAS u “akuzuan” nga struktura të shtetit shqiptar si “spiun të grekut”. Të njëjtat struktura, nga frika se këta “spiun” do të shndërroheshin në simbole nacionalizmi dhe irredentizmi grek, i dogjën duke iu publikuar pseudonimet që kishin në strukturat e shërbimeve sekrete shqiptare. Një pjesë tjetër “u arratis” në Greqi. Të tjerë dolën përseri në krye të OMONIAS duke rrembyer flamurin e vizionëve evropiane të bashkëjetesës paqësore dhe vëllazërimit tradicional me popullin shqiptar. Të gjithë ama janë të pasur, vazhdojnë të udhëheqin ose riciklohen kohë pas kohe në drejtimin e minoritetit grek.

Panajot Barka 24.04.2007 u botua me datën 25.04.2007 fq 1-10 gaz Albania

Στην ALBANIA δημοσιεύτηκε με συντομεύσεις. Για το λόγο αυτό το έστειλα σε άλλη εφημερίδα, στην "ABC» και δημοσιεύτηκε στις 26.04.2007 χωρίς καμιά αλλαγή, όπως είναι εδώ

Ευχαριστώ για την κατανόηση.

Άρθρο σχετικά με τη «δήλωση» Μπολάνο.

Δημοσιεύτηκε στην εφημερίδα ALBANIA, 25.04.07 με περικοπές, ενώ στις ABC και POLITIKA αντίστοιχα στις 26 και 28.04 χωρίς καμιά αλλαγή.

Την προηγούμενη Κυριακή, στις 22.04.2007 η εκπομπή «Exclusive» στην Tv Top Channel, υπό τον τίτλο, «Δούρειος Ίππος» επιδίωξε να υπενθυμίσει τα γεγονότα που οδήγησαν στις δυσκολότερες σχέσεις την Ελλάδα με την Αλβανία και το αλβανικό κράτος με την ελληνική μειονότητα στην Αλβανία. Πρόκειται για την 13^η επέτειο του επεισοδίου της Επισκοπής, το οποίο σημειώνει την απαρχή της αποκορύφωσης στην επιδείνωση των σχέσεων αυτών.

Εμείς, που προσωπικά βιώσαμε με πόνο και στωικότητα τα συγκεκριμένα γεγονότα, αναμέναμε η εκπομπή να έφερνε στην επικαιρότητα το πογκρόμ της κρατικής μηχανής εκείνης της εποχής κατά της ελληνικής μειονότητας. Η 22^α Απριλίου 1994 σημείωσε την αποκορύφωση της επιχείρησης των κρατικών δομών με επικεφαλής τη SHIK (μυστικές υπηρεσίες) κατά της ελληνικής μειονότητας. Πάνω από 250 στελέχη, διανοούμενοι και ιθύνοντες αυτής της μειονότητας προσήχθησαν στα αστυνομικά τμήματα. Μερικοί απ' αυτούς συνελήφθησαν. Πέντε φυλακίστηκαν και οδηγήθηκαν στο δικαστήριο. Δεκάδες σπίτια λεηλατήθηκαν νυχτιάτικα. Βίαια και χωρίς κανένα πρακτικό λεηλατήθηκαν όλα τα γραφεία της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, τα αρχεία της οποίας δεν επιστράφηκαν ποτέ. Εκατοντάδες μέλη αυτής της μειονότητας, άντρες και γυναίκες υποβλήθηκαν σε αυθαίρετες ανακρίσεις, παραβιάζοντας όλα τα δικαιώματά τους, με στόχο την απόσπαση υπαγορευμένων δηλώσεων και μαρτυριών.

Εκείνο, που επίσης πρέπει να σημειωθεί ως κάτι ανεξίτηλο στη μνήμη και τη συνείδηση της ελληνικής μειονότητας είναι το γεγονός ότι είχε στο πλευρό της την ολόπλευρη υποστήριξη του αλβανικού λαού, των μίντια, των κομμάτων της αντιπολίτευσης, μάλιστα και μερικών κρατικών δομών. Ήταν μια λαμπρή εκδήλωση ανοχής, συμβίωσης και αλληλεγγύης. Γι' αυτό νομίζω ότι η υπενθύμιση υπό αυτό το σκεπτικό εκείνης της πραγματικότητας των πριν 13 χρόνων γεγονότων, θα αποτελούσε την καλύτερη συμβολή στην πορεία ευρωπαϊκής ένταξης που εισήλθε η Αλβανία.

Όμως αυτή η πραγματικότητα λησμονήθηκε από όλους, μάλιστα και από την ΟΜΟΝΟΙΑ ή και το ΚΕΑΔ. Το Top Channel που την υπενθύμισε είχε ως σημείο αναφοράς τις γνωστές εθνικιστικές προκαταλήψεις στις αρχές του προηγούμενου αιώνα και κατά τον ψυχρό πόλεμο,- της αντιμετώπισης της εθνικής ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία ως τον «Δούρειο Ίππο στην υπηρεσία των ελληνικών σχεδίων προσάρτησης της Αλβανίας»

Για την επιτυχή στέψη του παλιού αυτού επιχειρήματος αξιοποιήθηκε «η νέα» δήλωση του δημάρχου της Χιμάρας και αντιπροέδρου της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, Βασίλη Μπολάνου. Όπως γίνεται γνωστό, στην εκπομπή αυτή αποσπάστηκε μια φράση από μια προ δύο μηνών συνέντευξη του κυρίου Μπολάνου που λέει ότι «...γνωρίζω ότι η ΟΜΟΝΟΙΑ έχει ζητήσει μονίμως αυτό. Εμείς δε ζητούμε περισσότερα απ' ό, τι η Αλβανία για το Κοσσυφοπέδιο. Αυτό είναι εις όφελος της Βαλκανικής και των ελληνικών μειονοτήτων στην Αλβανία» .(!?)

Αυτό, στο σύνολό της εμπειρίας των δέκα τελευταίων χρόνων, από κοινού με τις άλλες προσπάθειες των αλβανικών ΜΜΕ για να αντιμετωπίσουν την Ελλάδα ως μια κακόβουλη και όχι φιλική χώρα προς την Αλβανία, δημιουργεί ικανοποιητικές

προϋποθέσεις για να εγερθούν ερωτηματικά και θαυμαστικά σχετικά με τη δήλωση Μπολάνο.

Την επόμενη της εκπομπής «Exclusive» ο Μπολάνος βγήκε σε ένα άλλο κανάλι και δεν διέψευσε τίποτε απ' όσα είχε αναφέρει, σύμφωνα με τον ίδιο, πριν δύο μήνες. Γιατί μόνο μετά από μερικές μέρες επιδίωξε να πει ότι η δήλωσή του παραποιήθηκε, διότι, σύμφωνα με το Μπολάνο, αυτός μίλησε για τα ανθρώπινα δικαιώματα βάση της Σύμβασης Πλαίσιο κλπ; Μήπως επειδή αποστασιοποιήθηκαν από τη δήλωσή του ένας μετά τον άλλο ο βουλευτής της περιοχής Πέτση, ο Γενικός Γραμματέας του ΚΕΑΔ, Σόλης και (με μισόλογα) ο πρόεδρος της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, Γιάννης. Γιατί για τη διάψευση αυτή ο Μπολάνος επέλεξε περιφερειακά ΜΜΕ και όχι επίσημα ή και το ίδιο το κανάλι που καταχράστηκε τη δήλωσή του.

Λοιπόν, σε περίπτωση που πρόκειται πραγματικά για κατάχρηση τότε η σιωπή του Μπολάνου γίνεται πιο περίεργη αν έχουμε υπόψη το γεγονός ότι η αντιδράσεις των πολιτικών στη χώρα, των ΜΜΕ και του κοινού μεσουραρούν και είναι σκληρότατες. Τόσο το χειρότερο όταν στο επίκεντρό τους δεν βρίσκετε απλά ο Μπολάνος, αλλά όλη η εθνική ελληνική μειονότητα, η ιστορία, τα δικαιώματα και η σημερινή της πραγματικότητα καθώς και οι αντιπροσωπευτικοί της θεσμοί. Μπαίνει στο στόχαστρο η Ελλάδα κατά της οποίας οι εθνικιστικές ομάδες στην Αλβανία «βρίσκουν» στη δήλωση ένα επιπλέον επιχείρημα «για να αποδείξουν την ελληνική εχθρότητα κατά της Αλβανίας». Έχουμε λοιπόν την αποκορύφωση μιας νέας ανθελληνικής θύελλας. Σ' αυτή τη θύελλα συμπεριλαμβάνεται η αλβανική κοινή γνώμη. (Μόνο την πρώτη ημέρα μετά την ανακοίνωση της δήλωσης στην αλβανική ιστοσελίδα «Forum» καταγράφηκαν 145 επώνυμες και ανώνυμες αντιδράσεις με τις πιο εξτρεμιστικές θέσεις προς καθετί ελληνικό. Εδώ θα πρέπει να αναζητήσουμε και τη μεγάλη διαφορά με το 1994). Συμπεριλαμβάνονται τμήματα της πολιτικής μέχρι τη Βουλή. Στις αντιδράσεις τους παρατηρείται το ίδιο μήκος κύματος με το ανώνυμο πλήθος, ανεξάρτητα από την λακωνικότητα της γλώσσας των πολιτικών.

Κατά περίεργο τρόπο όμως, στη συγκεκριμένη «θύελλα» δεν συμπεριλαμβάνονται η αρμόδιες κρατικές δομές, ούτε για την επιβεβαίωση της δήλωσης, ούτε για τη λήψη ανάλογων μέτρων. Τόσο το περισσότερο όταν διαπιστώνουν πως τόσο «ως κροτίδα», όσο και «ως πραγματική», η δήλωση μετατρέπεται σε μια κακή αλχημεία που οδηγεί στην περιθωριοποίηση της εθνικής ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία, στην απόσπασή της από την αλβανική κοινωνία. Μετατρέπεται σε διαδικασία δαιμονισμού αυτής της μειονότητας και της Ελλάδας στην Αλβανία. Μάλιστα, στην υπηρεσία αυτού του σκοπού, οι εμπνευστές του δε δέχονται να παρατηρήσουν ότι ανάμεσα στην αντίληψη «ανεξαρτησία» (του Κοσσυφοπεδίου) και «αυτονομία» (της Βορείου Ηπείρου) δεν υπάρχει καμιά εγγύτητα. Επίσης, δεν μπορεί να μη προσέξει κανείς ότι ενώ επιδιώκεται ώστε η «η δήλωση» Μπολάνο να αντιμετωπισθεί ως προσπάθεια τρικλοποδιάς των εξελίξεων στο Κοσσυφοπέδιο, ο πραγματικός σκοπός είναι η εθνική και πολιτική υποβάθμιση και αποδιάρθρωση της εθνικής ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία, έναντι του πολλαπλασιασμού των ενεργειών για την προβολή «του τσάμικου ζητήματος» και τον παραλληλισμό αυτού με την ελληνική μειονότητα, πραγματικότητες οι οποίες στην ουσία δεν έχουν καμιά σχέση.

Επίσης, η πρόσφατη πολιτική συμπεριφορά του Μπολάνου εγείρει και ένα ακόμα ερωτηματικό. Μετά τη νίκη στην πρώτη θητεία ο Μπολάνος δεν τολμούσε να αναφέρει στο αλβανικό κοινό την ελληνική εθνικότητα, τόσο για τον ίδιο όσο και για την κοινότητα της Χιμάρας. Η έναρξη της πρόσφατης εκλογικής εκστρατείας έγινε με ένα εντελώς αντίθετο τρόπο, ενώ ολοκληρώθηκε με ευχαριστίες προς το Μπερίσια για τη νίκη του.

Το άλλο ερώτημα σχετίζεται με το γεγονός ότι την προσωπική του θέση την μεταφέρει ως θέση της ΟΜΟΝΟΙΑΣ. Εκείνη, από τότε που ιδρύθηκε ως πολιτικός εκπρόσωπος της εθνικής ελληνικής μειονότητας, δεν έχει υιοθετήσει ποτέ κατ' επίσημο τρόπο, θέσεις που ο Μπολάνος της αποδίδει.

Έτσι, στις αρχές του 1992, η ΟΜΟΝΟΙΑ δεν υιοθέτησε επίσημα τη δήλωση των βουλευτών στη Βουλή, η οποία έλεγε ότι σε περίπτωση που στην ΟΜΟΝΟΙΑ δεν θα αναγνωρισθεί το δικαίωμα εκλογικού φορέα στις εκλογές του Μάρτη 1992, τότε η ελληνική μειονότητα θα είναι αναγκασμένη να ζητήσει την επανεξέταση του καθεστώτος της στην Αλβανία. Επίσης, στη Συνδιάσκεψη της ΟΜΟΝΟΙΑΣ της 10^{ης} Απριλίου 1994, έπεσε στο κενό το αίτημα μερικών αντιπροσώπων ώστε στελέχη της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, πριν δημοσιοποιήσουν ως της οργάνωσης τις προσωπικές τους θέσεις για «αυτονομία», θα πρέπει να τις θέσουν προς έγκριση στο ανώτατο αρμόδιο όργανο, τη Γενική Συνδιάσκεψη,- όπως προβλέπει και το καταστατικό της.

Στις αρχές του 1999, ο ίδιος ο Μπολάνος, ο οποίος μόλις είχε αναδειχθεί στέλεχος της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, τάχτηκε κατά ψηφίσματος του Γενικού Συμβουλίου της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, το οποίο ψήφισμα ήταν μάλιστα σε ανταπόκριση της δήλωσης του προέδρου Κλίντον για την ισότητα ανάμεσα στα ανθρώπινα δικαιώματα στο Κοσσυφοπέδιο και την ελληνική μειονότητα στην Αλβανία. (!!!)

Στο σημείο αυτό επισύρουμε την προσοχή τονίζοντας ότι θα ήταν προς τιμή του Μπολάνου, ή οποιουδήποτε άλλου, ώστε πριν καταναλώσουν στο κοινό τέτοιου είδους θέσεις, να αγωνιστούν, σεβόμενοι το σύνταγμα της χώρας και τις διεθνείς συμβάσεις, για την υιοθέτηση αυτών ως προγραμματικές θέσεις πρώτα από την ΟΜΟΝΟΙΑ και το ΚΕΑΔ. Στην προκειμένη περίπτωση είναι απλώς καταχραστικές και στρέφονται κατά των συμφερόντων της ίδιας της μειονότητας. Τόσο το χειρότερο όταν οι αντιπροσωπευτικοί θεσμοί της ελληνικής μειονότητας, αν και συμπληρώνουν δέκα χρόνια στην εξουσία δεν είναι σε θέση να αναγκάσουν τις αλβανικές κυβερνήσεις ούτε για να εξασφαλίσουν στους Έλληνες μειονοτικούς μαθητές στα δημόσια σχολεία στη μητρική γλώσσα, σχολικά βιβλία στη μητρική τους γλώσσα.

Εμμένουμε στη ιδέα αυτή διότι και σήμερα, μετά από τόσα χρόνια, δεν μπορεί να μη παρατηρήσουμε ότι ως αφετηρία στην πιο σκοτεινή στιγμή στη ζωή της ελληνικής μειονότητας κατά την περίοδο του αλβανικού πλουραλισμού (την οποία υπενθύμισε αντίστροφα το Top Channel) χρησίμευσε μια δήλωση ενός τοπικού παράγοντα της ΟΜΟΝΟΙΑΣ σε μια περιφερειακή και ανώνυμη ελληνική εφημερίδα. Και εκείνη η δήλωση έλεγε ότι δήθεν η ΟΜΟΝΟΙΑ, τότε σε πολύ νεαρή ηλικία, «αγωνίζονταν για την Ένωση της Βορείου Ηπείρου με την Ελλάδα». (!!!). Η δήλωση πήρε γρήγορα διαστάσεις και σε υψηλά και σημαντικά επίπεδα. Αναμενόταν τότε ώστε η Βουλή να αποφάσιζε αν θα ήταν ή όχι εκλογικός φορέας η ΟΜΟΝΟΙΑ. Οι βουλευτές της ΟΜΟΝΟΙΑΣ εκλήθησαν αμέσως στην αμερικανική πρεσβεία. Ζητήθηκε απ' αυτούς να αποστασιοποιηθούν. Η αποστασιοποίηση έγινε με δήλωση την ίδια μέρα στη Βουλή, ενώ ουσιαστικά αναμενότανε το αντίθετο. Παρόλα αυτά τίποτε δεν άλλαξε στην εθνική κοινοβουλευτική ενότητα μεταξύ δεξιάς και αριστεράς, που προκάλεσε η συγκεκριμένη δήλωση του τοπικού στελέχους της ΟΜΟΝΟΙΑΣ. Συνεπώς η ΟΜΟΝΟΙΑ ανακηρύχτηκε «Δούρειος Ίππος»

Αποτελεί επίσης, αλήθεια το γεγονός ότι για όλη την «εθνικιστική» δραστηριότητα της τότε ηγετικής ομάδας της ΟΜΟΝΟΙΑΣ, οι αρμόδιες δομές του αλβανικού κράτους διέθεταν πλήρη ενημέρωση. Παρόλα αυτά «στους ηγέτες» δεν έμπαινε ούτε αγκάθι στο πόδι τους, ενώ οι απλοί Έλληνες μειονοτικοί που τους ακολουθούσαν δέχονταν τα γκλομπς. Επίσης, για την καλύτερη προβολή του «εθνικισμού» της ελληνικής μειονότητας και της ίδιας της Ελλάδας, ήταν συχνά αναγκαίες και αλβανικές θυσίες.

Για το επεισόδιο της Επισκοπής, λ.χ, δεν πρέπει να λησμονηθούν μερικά στοιχεία που προέκυψαν από τις ανακρίσεις. Παραβαίνοντας τον νόμο, οι νεοσύλλεκτοι συνοριακοί μεταφέρθηκαν στα σύνορα πριν ορκισθούν. Συνεπώς δεν επιτρέπονταν σ' αυτούς η χρήση πολεμικών όπλων. Επίσης, το στρατιωτικό τμήμα της Επισκοπής όπου εγκαταστάθηκαν δεν είχε καμία επικοινωνία με το κέντρο του, ενώ τα πραχτικά των ημερών λίγο πριν το επεισόδιο έχουν εξαφανιστεί.

Σαν αποτέλεσμα, η «εθνικιστική» δράση των ηγετικών στελεχών της ελληνικής μειονότητας, έδωσε κάθε «δικαίωμα» στο κράτος να αντιμετωπίσει την κοινότητα της ελληνικής μειονότητας με μονόπλευρη βία. Μονόδρομος για εκείνη ήταν η φυγή προς Ελλάδα. Τα στατιστικά στοιχεία μαρτυρούν ότι ο αριθμός των μελών της ελληνικής μειονότητας που πήραν το δρόμο μισεμού προς Ελλάδα την περίοδο αυτή ήταν περίπου ο διπλάσιος εκείνων που έφυγαν από τον τόπο τους μετά την οριοθέτηση των συνόρων. (Για την περίοδο 1912-45 αριθμούνται γύρω στις 20 χιλιάδες άτομα). Μάλιστα, διαφορετικά από κείνη την περίοδο που έφευγαν μόνο άνδρες, τώρα πρόκειται για ομαδική οικογενειακή φυγή.

Ωστόσο, μερικοί από αυτούς τους «εθνικιστικούς ιθύνοντες» της ΟΜΟΝΟΙΑΣ «κατηγορήθηκαν» από τις αλβανικές κρατικές δομές ως «πράκτορες των Ελλήνων». Οι ίδιες δομές, φοβούμενες ότι «οι πράκτορες» αυτοί θα μετατρέπονταν σε σύμβολα του ελληνικού εθνικισμού, τους έκαψαν αποκαλύπτοντάς τους τα ψευδώνυμα που είχαν στην υπηρεσία των αλβανικών μυστικών υπηρεσιών. Ένα άλλο τμήμα αυτών «δραπέτευσε» στην Ελλάδα. Οι υπόλοιποι, άλλαξαν θέση 180 μοιρών, άδραξαν τη σημαία των ευρωπαϊκών οραμάτων για ειρηνική συνύπαρξη και παραδοσιακή αδελφοσύνη με τον Αλβανικό λαό και βγήκαν ξανά επικεφαλής της ΟΜΟΝΟΙΑΣ. Όλοι τους όμως είναι πλούσιοι. Συνεχίζουν να καθοδηγούν ή να ανακυκλώνονται κατά καιρούς στην διοίκηση της ελληνικής μειονότητας.

Του Π. Μπάρκα.

Δημοσιεύτηκε στην εφημερίδα ALBANIA, 25.04.07 με περικοπές, ενώ στις ABC και POLITIKA αντίστοιχα στις 26 και 28.04 χωρίς καμιά αλλαγή.